



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i dosjes:** KSC-SC-2025-06

**Vendosi:** Paneli i Dhomës së Gjykatës Supreme

Gjykatëse, Ekaterina Trendafilova, Kryegjykatëse  
Gjykatëse Kristinë van den Vajngart  
Gjykatës Daniel Fransen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 9 mars 2026

**Gjuha origjinale:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë**

---

**Prokurores së Specializuar:**

Kimberli P. Uest

**Mbrojtjes së Pjetër Shalës**

Zhan-Lui Zhilisen

**Mbrojtjes së Viktimave**

Sajmon Loz

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SUPREME** i Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Paneli i Gjykatës Supreme” ose “Paneli”) duke marrë parasysh nenet 33 dhe 162(2) të Kushtetutës,<sup>1</sup> nenet 3, 12, 14(1), 16(1), 44(2) dhe 48(6), (7) dhe (8) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar<sup>2</sup> (“Ligji”) dhe rregullat 193 dhe 194(1)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”)<sup>3</sup> ka marrë në shqyrtim Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcën Konfidenciale 1 (“Kërkesa e Shalës” ose “Kërkesa”).<sup>4</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 korrik 2024, Trupi Gjykses I shpalli aktgjykimin dhe e dënoi z. Pjetër Shala me 18 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim (“Aktgjykimi”).<sup>5</sup>

2. Më 29 nëntor 2024, Trupi Gjykses I lëshoi Urdhrin për Zhdëmtim kundër Pjetër Shalës, me të cilin urdhëroi z. Shala të paguante shumën prej 208.000 eurosh si kompensim për dëmin e shkaktuar viktimave të krimeve për të cilat u shpall fajtor.<sup>6</sup>

3. Më 14 korrik 2025, Paneli i Apelit lëshoi aktgjykimin, ku, ndër të tjera, miratoi pjesërisht Pikat 7, 12 dhe 14 të z. Shala, dhe prapësoi pjesërisht verdiktet e fajësisë së tij për Pikat 1 dhe 3 të Aktakuzës në lidhje me “pjesët e tyre që bazohen në ndalimin arbitrar të dy personave dhe në torturimin e pesë personave” (“Aktgjykimi i Apelit”).<sup>7</sup>

Paneli i Apelit rrëzoi apelin e z. Shala “për të gjitha aspektet e tjera”,<sup>8</sup> dhe la në fuqi

<sup>1</sup> Kushtetuta e Kosovës (me amendamentet I-XXIV), 5 gusht 2015.

<sup>2</sup> Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, nr. 05/L-053.

<sup>3</sup> Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, (miratuar më 17 mars 2017, rishikuar më 29 maj 2017, ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020).

<sup>4</sup> PL001/F00001, Kërkesë e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcën Konfidenciale 1, 14 tetor 2025. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 25 nëntor 2025, F00001/RED.

<sup>5</sup> KSC-BC-2024-04/F00847/RED, Aktgjykim dhe Dënim me një Shtojcë Konfidenciale, 16 korrik 2024, para. 1124.

<sup>6</sup> KSC-BC-2024-04/F00866, Urdhër për Zhdëmtim kundër Pjetër Shalës, 29 nëntor 2024 (konfidencial), para. 239. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 23 dhjetor 2024, F00866/RED.

<sup>7</sup> KSC-CA-2024-03/F00069, Aktgjykim i Apelit, 14 korrik 2025, para. 938.

<sup>8</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 938.

verdiktet e fajësisë së tij për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme, por anuloi dënimet e dhëna për Pikat 3 dhe 4 të Aktakuzës dhe i dha atij një dënim të rishikuar me 13 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.<sup>9</sup>

4. Më 23 korrik 2025, z. Shala dorëzoi Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatje Afati dhe Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve për Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, ku kërkoi zgjatjen me 60 ditë të afatit të parashikuar në Rregullore për dorëzimin e kërkesës së tij për mbrojtje të ligjshmërisë dhe shtimin e numrit të lejuar të fjalëve për Kërkesën.<sup>10</sup>

5. Më 25 korrik 2025, Kryetarja caktoi Panelin e Gjykatës Supreme për shqyrtimin e çdo kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë që do të dorëzohej nga z. Shala, si dhe të çdo aspekti tjetër të lidhur me të.<sup>11</sup>

6. Më 8 gusht 2025, Paneli i Gjykatës Supreme rrëzoi kërkesën për zgjatje të afatit dhe shtim të numrit të lejuar të fjalëve.<sup>12</sup>

7. Më 14 tetor 2025, Mbrojtja dorëzoi Kërkesën.

8. Më 16 tetor 2025, Paneli i Gjykatës Supreme lëshoi Urdhrin mbi Afatet për Dorëzimin e Parashtrimeve.<sup>13</sup>

9. Më 3 dhjetor 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS” ose “Prokuroria”) dhe Mbrojtja e Viktimave dorëzuan përgjigjet e tyre (përkatësisht, “Përgjigjja e ZPS-së” dhe “Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave”).<sup>14</sup>

---

<sup>9</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 938.

<sup>10</sup> F00001, Kërkesë e Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit dhe Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve për Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 23 korrik 2025.

<sup>11</sup> F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës Supreme, 25 korrik 2025.

<sup>12</sup> F00005, Vendim mbi Kërkesën për Zgjatje Afati dhe Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve, 8 gusht 2025.

<sup>13</sup> PL001/F00002, Urdhër mbi Afatet për Dorëzimin e Parashtrimeve, 16 tetor 2025.

<sup>14</sup> PL001/F00004, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Pjetër Shalës për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcën Publike 1, 3 dhjetor 2025 (konfidenciale); PL001/F00003, Përgjigje e Mbrojtjes së Viktimave

10. Më 16 janar 2026, Mbrojtja dorëzoi Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjeve të Prokurorisë dhe të Mbrojtjes së Viktimave në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë (“Kundërpërgjigjja e Shalës”).<sup>15</sup>

## II. PRANUESHMËRIA

11. Paneli thekson se Aktgjykimi i Apelit është i formës së prerë dhe se z. Shala e dorëzoi Kërkesën brenda afatit tremujor të përcaktuar në nenin 48(6) të Ligjit, pas shqiptimit të këtij Aktgjykimi. Rrjedhimisht, Kërkesa është e pranueshme në këtë aspekt dhe, për rrjedhojë, Paneli do të vijojë me vlerësimin e secilës pikë të përfshirë në të.

12. Në qoftë se pika nuk përmbush kriteret e pranueshmërisë të standardit të shqyrtimit sikurse përcaktohet dhe shtjellohet në vijim,<sup>16</sup> Paneli do ta rrëzojë atë pa trajtuar themelësinë e saj.

## III. STANDARDI I SHQYRTIMIT

13. Paneli rikujton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të cilësohet si apel në shkallë të tretë,<sup>17</sup> dhe në të nuk ngrihen aspekte sipas nenit 48(1) deri (5) të Ligjit. Ajo është mjet juridik i jashtëzakonshëm i parashikuar në nenin 48(6) dhe (7) të Ligjit dhe në rregullat 193 dhe 194 të Rregullores. Qëllimi i saj nuk është të krijojë një mundësi tjetër të përgjithshme për apel.<sup>18</sup> Përkundrazi, dhe ngjashëm me Kodin e

---

ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcën Publike 1, 3 dhjetor 2025 (konfidenciale).

<sup>15</sup> F00007, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj Përgjigjeve të Prokurorisë dhe të Mbrojtjes së Viktimave në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 16 janar 2026 (konfidenciale).

<sup>16</sup> KSC-BC-2020-06/PL001/F00008, Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 15 gusht 2022, para. 17-18, 23-24.

<sup>17</sup> Shih nenin 47 të Ligjit.

<sup>18</sup> KSC-BC-2020-06/PL002/F00005, Vendim mbi Kërkesën e z. Veseli për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 19 dhjetor 2025 (“Vendimi në lidhje me Veselin”), para. 17; KSC-BC-2020-06/F00004, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Krasniqit për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 29 dhjetor 2025 (“Vendimi në lidhje me Krasniqin”), para. 18; KSC-SC-2024-02/F00018, Vendim mbi Kërkesën e Salih Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 29 korrik 2024 (“Vendimi në lidhje me Mustafën”), para. 11; KSC-SC-2023-01/F00021,

Procedurës Penale të Kosovës,<sup>19</sup> kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë bëhet vetëm për raste specifike të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore. Sikurse ka theksuar Gjykata Supreme e Kosovës:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, si një ndër mjetet e jashtëzakonshme ligjore, është mjeti përjashtimor ligjor që synon të korrigjojë mundësisht zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale. Kërkesat e rrepta të pranueshmërisë synojnë të sigurojnë që ky mjet ligjor të mos përdoret si një shkallë e tretë e përgjithshme kundër të gjitha vendimeve në procedurën penale.<sup>20</sup>

14. Rrjedhimisht, për pikat ku mbështetet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë zbatohen kritere të rrepta të pranueshmërisë.<sup>21</sup>

15. Gjatë vlerësimit të secilës pike, Paneli përcakton nëse ka shkelje të së drejtës penale të përfshirë në Ligj ose shkelje thelbësore të procedurave të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore.<sup>22</sup>

16. Argumentet që mund të ishin paraqitur në mënyrë të arsyeshme para paneleve në shkallë të parë dhe të dytë, nuk mund të paraqiten *de novo* para Panelit të Gjykatës Supreme.<sup>23</sup>

17. Gjithashtu, arsyet në të cilat bazohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë me të cilat pretendohet për përcaktim të gabuar ose të paplotë të fakteve, nuk janë në kompetencën e këtij Paneli dhe, për rrjedhojë, janë të papranueshme.<sup>24</sup>

18. Thjesht mospajtimi me vlerësimin e fakteve nga gjykatat e shkallës së parë dhe

---

Vendim mbi Kërkesat për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 18 shtator 2023 (“Vendimi në lidhje me Gucatin dhe Haradinajn”), para. 9.

<sup>19</sup> Shih nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës nr. 08/L-032, Gazeta Zyrtare nr. 24, 17 gusht 2022.

<sup>20</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, S.S., Pml.Kzz 42/2017, Aktgjykim, 10 maj 2017, para. 23; Vendimi në lidhje me Veselin, para. 17; Vendimi në lidhje me Krasniqin, para. 18.

<sup>21</sup> Vendimi në lidhje me Veselin, para. 18; Vendimi në lidhje me Krasniqin, para. 19.

<sup>22</sup> Neni 48(7) i Ligjit; Vendimi në lidhje me Veselin, para. 19; Vendimi në lidhje me Krasniqin, para. 20.

<sup>23</sup> Vendimi në lidhje me Veselin, para. 20; Vendimi në lidhje me Krasniqin, para. 21; Vendimi në lidhje me Mustafën, para. 14; Vendimi në lidhje me Gucatin dhe Haradinajn, para. 10.

<sup>24</sup> Rregulla 193(3) e Rregullores. Shih gjithashtu Vendimin në lidhje me Veselin, para. 21; Vendimin në lidhje me Krasniqin, para. 22; Vendimin në lidhje me Mustafën, para. 15; Vendimin në lidhje me Gucatin dhe Haradinajn, para. 10.

të dytë, ose përsëritja fjalë për fjalë e parashtrimeve të bëra në apelet e mëparshme, pa trajtuar në mënyrë thelbësore vendimin e kundërshtuar apo aktgjykimin e formës së prerë dhe pa evidentuar gabimin apo shkeljen konkrete të pretenduar, janë po ashtu të pamjaftueshme për të përmbushur standardin e pranueshmërisë së këtyre pikave.<sup>25</sup>

19. Paneli i Gjykatës Supreme rikujton se më parë ka përcaktuar standardin e shqyrtimit që zbatohet për kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë që kanë të bëjnë me *shkelje thelbësore të procedurave* në lidhje me aktgjykimet e formës së prerë.<sup>26</sup> Paneli rikujton standardin e lartë të përcaktuar në nenin 48(7)(b) të Ligjit në lidhje me shkeljet thelbësore të procedurave.<sup>27</sup> Më konkretisht, Paneli vendosi se “shkelje thelbësore” të procedurave ka kur kjo shkelje “ka ndikim juridikisht thelbësor në konstatimin gjyqësor”.<sup>28</sup> Pretendimi për shkelje thelbësore të procedurave sikurse përcaktohet në Ligj dhe Rregullore duhet të vlerësohet rast pas rasti, duke marrë parasysh rrethanat në të cilat bazohet secila kërkesë.<sup>29</sup>

20. Gjithashtu, Paneli i Gjykatës Supreme rikujton se mund të konstatojë shkelje thelbësore të procedurave në qoftë se, për shembull, Paneli i Gjykatës së Apelit: (i) nuk ka zbatuar një dispozitë të Ligjit ose Rregullores; (ii) ka zbatuar në mënyrë të gabuar Ligjin dhe/ose Rregulloren; ose (iii) ka shkelur të drejtat e Mbrojtjes në një mënyrë që ka ndikuar në dhënien e një vendimi të ligjshëm dhe të drejtë.<sup>30</sup>

21. Paneli gjithashtu përcaktoi standardin e shqyrtimit që zbatohet në lidhje me

---

<sup>25</sup> Vendimi në lidhje me Veselin, para. 22; Vendimi në lidhje me Krasniqin, para. 23; Vendimi në lidhje me Mustafën, para. 16; Vendimi në lidhje me Gucatin dhe Haradinajn, para. 10; Vendimi në lidhje me Veselin, para. 25.

<sup>26</sup> Vendimi në lidhje me Mustafën, para. 17; Vendimi në lidhje me Gucatin dhe Haradinajn, para. 13.

<sup>27</sup> Vendimi në lidhje me Veselin, para. 23; Vendimi në lidhje me Krasniqin, para. 24; Vendimi në lidhje me Mustafën, para. 17; Vendimi në lidhje me Gucatin dhe Haradinajn, para. 14.

<sup>28</sup> Vendimi në lidhje me Veselin, para. 23; Vendimi në lidhje me Krasniqin, para. 24; Vendimi në lidhje me Mustafën, para. 17; Vendimi në lidhje me Gucatin dhe Haradinajn, para. 14.

<sup>29</sup> Shih gjithashtu Gjykata Supreme e Kosovës, NV, Pml.Kzz 91/2015, Aktgjykim, 14 maj 2015, para. 4, 10-12; AM, Pml.Kzz 84/2015, Aktgjykim, 12 maj 2015, f. 3-4; M.I., Pml.Kzz 26/2015, Aktgjykim, 18 mars 2015, f. 5-7; Vendimin në lidhje me Veselin, para. 23; Vendimin në lidhje me Krasniqin, para. 24.

<sup>30</sup> Vendimi në lidhje me Veselin, para. 24; Vendimi në lidhje me Krasniqin, para. 25; Vendimi në lidhje me Mustafën, para. 18; Vendimi në lidhje me Gucatin dhe Haradinajn, para. 14.

shkeljen apo shkeljet e të drejtës penale të përcaktuar në nenin 48(7)(a) të Ligjit.<sup>31</sup> Paneli konstatoi se ky nen nuk kërkon që shkelja e të drejtës penale të jetë “thelbësore”.<sup>32</sup>

22. Gjithashtu, Paneli vëren listën shteruese të shkeljeve të së drejtës penale të përcaktuar në nenin 385(1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe gjykon se shkeljet e së drejtës penale, nëse ka, kufizohen vetëm në shkeljet e përmendura aty. Konkretisht, këto shkelje ndodhin kur: (i) vepra për të cilin i akuzuari ndiqet penalisht nuk është vepër penale; (ii) ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale, sidomos në qoftë se ndjekja penale është parashkruar ose është përjashtuar për shkak të amnistisë apo faljes, ose është gjykuar më parë me aktgjykim të formës së prerë; (iii) ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale; (iv) lidhur me veprën e gjykuar penale është zbatuar një ligj që nuk mund të zbatohet; (v) në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim, gjykata ka tejkuluar kompetencat ligjore; ose (vi) janë shkelur dispozitat për sa i përket llogaritjes së periudhës së paraburgimit, arrestit shtëpiak, çdo periudhe të heqjes së lirisë si dhe të dënimit të kryer më parë lidhur me veprën penale objekt i procedurës penale.<sup>33</sup>

23. Paneli thekson se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të bazohet edhe në nenin 48(8) të Ligjit, ku përcaktohet se kërkesa për mjete juridike të jashtëzakonshme mund të paraqitet edhe në bazë të të drejtave sipas këtij ligji, të cilat gjithashtu janë të mbrojtura me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”). Paneli gjykon se çdo shkelje e të drejtave sipas Ligjit, të cilat mbrohen edhe nga KEDNJ-ja, duhet të përmbushë të njëjtin standard shqyrtimi të përcaktuar më lart.<sup>34</sup>

<sup>31</sup> Vendimi në lidhje me Mustafën, para. 19; Vendimi në lidhje me Gucatin dhe Haradinajn, para. 17.

<sup>32</sup> Vendimi në lidhje me Mustafën, para. 19; Vendimi në lidhje me Gucatin dhe Haradinajn, para. 17.

<sup>33</sup> Neni 385(1)(1.1-1.6) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Shih gjithashtu Vendimin në lidhje me Mustafën, para. 20; Vendimin në lidhje me Gucatin dhe Haradinajn, para. 17.

<sup>34</sup> Shih Vendimin në lidhje me Veselin, para. 25; Vendimin në lidhje me Krasniqin, para. 26; Vendimin në lidhje me Mustafën, para. 21; Vendimin në lidhje me Gucatin dhe Haradinajn, para. 18.

24. Paneli gjithashtu ka konstatuar se pala që kërkon mbrojtje të ligjshmërisë duhet të evidentojë qartë shkeljen e pretenduar të ligjit, ta faktojë atë dhe, në rast të shkeljes së procedurave, të tregojë se si ka ndikuar thelbësisht në aktgjykimin e kundërshtuar.<sup>35</sup>

25. Së fundi, Paneli rikujton rregullën 194(1) të Rregullores, në të cilën përcaktohet se nëse Paneli i Gjykatës Supreme miraton kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, në varësi të llojit të shkeljes, paneli:

- (a) modifikon aktvendimin ose aktgjykimin e kontestuar;
- (b) anulon tërësisht ose pjesërisht aktvendimin ose aktgjykimin e kontestuar dhe ia kthen çështjen për vendim të ri ose rigjykim panelit kompetent; ose
- (c) kufizohet vetëm në konfirmimin e ekzistencës së një shkeljeje ligjore.

26. Pasi ka rikujtuar standardin e shqyrtimit, Gjykata Supreme do të shqyrtojë pikat në të cilat bazohet Kërkesa.

#### IV. DISKUTIM

##### A. KOHA QË KA KALUAR (PIKA 1)

###### 1. Parashtrimet

27. Z. Shala parashtron se vonesa prej 24 vjetësh midis ngjarjeve dhe gjyimit të tij e vështirësoi shumë realizimin e të drejtës për gjykim të drejtë.<sup>36</sup> Sipas z. Shala, koha jashtëzakonisht e madhe që kaloi çoi në degradimin ose asgjësimin e provave: dëshmitarët që kishin informacion shfajësues ndërruan jetë ose nuk mund të gjendeshin; kujtesa e dëshmitarëve të mbijetuar u përkeqësua dhe u humbën mundësi hetimore kyçe si dëshmia e z. Ruzhdi Saramati.<sup>37</sup> Si rezultat, Mbrojtja nuk mundi të identifikonte ose të pyeste individë që ishin të pranishëm gjatë kohës së ngjarjeve, dhe

<sup>35</sup> Vendimi në lidhje me Veselin, para. 26; Vendimi në lidhje me Krasniqin, para. 27; Vendimi në lidhje me Mustafën, para. 22; Vendimi në lidhje me Gucatin dhe Haradinajn, para. 19. Shih gjithashtu Vendimin në lidhje me Veselin, para. 37-38, 58, 70-71, 76, dhe Vendimin në lidhje me Krasniqin, para. 42-43, 49-50, 60, ku Paneli e zbatoi këtë standard duke konstatuar se Mbrojtja nuk evidentoi shkelje konkrete të ligjit ose procedurave, nuk paraqiti mospajtime për faktet dhe nuk provoi ndonjë gabim juridikisht thelbësor që ndikoi në vendimin e kundërshtuar.

<sup>36</sup> Kërkesa e Shalës, para. 5.

<sup>37</sup> Kërkesa e Shalës, para. 6, 9.

nuk mundi të merrte prova dokumentare ose të mjekësisë ligjore për të kundërshtuar provat e Prokurorisë, çka dëmtoi të drejtën e z. Shala për gjykim të drejtë.<sup>38</sup>

28. Gjithashtu, Mbrojtja parashtron se si Trupi Gjykues ashtu dhe Paneli i Apelit përmbysën detyrimin e vërtetimit duke ia lënë atë z. Shala, dhe duke i kërkuar atij të provonte si të pavërteta gjëra që Prokuroria duhej t'i vërtetonte jashtë dyshimit të arsyeshëm.<sup>39</sup> Të marra së bashku, Mbrojtja argumenton se koha e gjatë e kaluar që nga ngjarjet që çuan në këtë çështje gjyqësore dhe qasja e paneleve, dëmtuan në mënyrë fatale besueshmërinë dhe drejtësinë e procesit.

29. ZPS-ja përgjigjet se Pika 1 e z. Shala duhet të rrëzohet pasi ankesa e tij për kohën që ka kaluar është në papajtueshmëri me konstatimet tashmë të bëra, dhe ai nuk evidenton shkelje konkrete të të drejtës për gjykim të drejtë.<sup>40</sup> ZPS-ja parashtron se ankesa e z. Shala për mosdisponueshmërinë e z. Ruzhdi Saramati është e gabuar, pasi i akuzuari nuk e paraqiti këtë argument në dosjen e apelit të tij dhe nuk evidentoi në apel ndonjë mundësi hetimore konkrete të humbur.<sup>41</sup>

30. ZPS-ja gjithashtu parashtron se pretendimi i z. Shala për "përmbysje të detyrimit të vërtetimit" në lidhje me z. Osman Kryeziu, është argument i papranueshëm i paraqitur *de novo* dhe është hamendësues, duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e provave që mbështesin konstatimet përkatëse.<sup>42</sup> Së fundi, ZPS-ja argumenton se mbështetja e z. Shala në çështjen gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ"), *Nicolau k. Qipros*, është e gabuar, pasi ajo çështje ka të bëjë me dëmin e demonstrueshëm të shkaktuar hetimit nga kalimi i kohës, çka kërkon faktim konkret, diçka që z. Shala nuk e ka bërë.<sup>43</sup>

---

<sup>38</sup> Kërkesa e Shalës, para. 7-8.

<sup>39</sup> Kërkesa e Shalës, para. 10-13.

<sup>40</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 5.

<sup>41</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 6.

<sup>42</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 7.

<sup>43</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 8.

31. Z. Shala përgjigjet se Prokuroria nuk trajton thelbin e argumenteve të tij, konkretisht se koha që ka kaluar ka dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme Mbrojtjen pasi ka çuar në dëmtimin e provave, zbehjen e kujtimeve dhe humbjen e materialeve që mund të jenë shfajësuese, dëm ky që nuk mund të ndreqet vetëm me garanci procedurale.<sup>44</sup> Z. Shala gjithashtu pretendon se Prokuroria keqinterpreton relevancën e çështjes *Nikolau k. Qipros* duke anashkaluar shqetësimin kryesor të tij, pra se z. Shala duhet të provojë se mbrojtja e tij “u dëmtua rëndë”, i ngarkon atij një barrë të paarsyeshme dhe se duhej të ishte treguar kujdes më i madh kur u vlerësua mbështetshmëria e provave të Prokurorisë, duke pasur parasysh kohën që ka kaluar.<sup>45</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës Supreme

32. Paneli rikujton se sipas nenit 48(7)(b) të Ligjit dhe standardeve të zbatueshme të shqyrtimit, pala që kërkon mbrojtjen e ligjshmërisë duhet të evidentojë dhe faktojë shkeljen e pretenduar të ligjit,<sup>46</sup> dhe në rast të një shkeljeje thelbësore të procedurave, të tregojë se si ka ndikuar thelbësisht në aktgjykimin e kundërshtuar.<sup>47</sup> Paneli rikujton se “palët pritet të jenë të sakta në argumentet e tyre para Dhomave të Specializuara”.<sup>48</sup> Paneli gjithashtu rikujton se, kur nuk ka referenca për shkelje të Rregullores apo neneve të Ligjit, Paneli mund ta rrëzojë një pikë si të papranueshme.<sup>49</sup>

33. Z. Shala nuk përmend ndonjë dispozitë ligjore që mund të jetë shkelur dhe as evidenton qartë ndonjë shkelje thelbësore të një procedure konkrete në Ligj apo Rregullore në raport me këtë pikë.<sup>50</sup> Në mënyrë të ngjashme, z. Shala nuk përmend ndonjë nen të KEDNJ-së të pasqyruar në Ligj apo Rregullore. Në të këtyre, z. Shala

---

<sup>44</sup> Kundërpërgjigjja e Shalës, para. 2.

<sup>45</sup> Kundërpërgjigjja e Shalës, para. 3.

<sup>46</sup> Shih nenin 48(7)(b) të Ligjit; Vendimin në lidhje me Veselin, para. 37.

<sup>47</sup> Vendimi në lidhje me Mustafën, para. 13, 22.

<sup>48</sup> KSC-BC-2023-10/PL001, Vendim mbi Kërkesën e Haxhi Shalës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 9 shtator 2024 (“Vendimi mbi Kërkesën e H. Shalës për Mbrojtje të Ligjshmërisë”), para. 33.

<sup>49</sup> Vendimi mbi Kërkesën e H. Shalës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 33.

<sup>50</sup> Kërkesa e Shalës, para. 5-13.

vetëm përmend në mënyrë të përgjithshme shkeljen e “drejtësisë së procesit”.<sup>51</sup>

34. Pa një specifikim të qartë të bazës ligjore për shkeljen e pretenduar, për Panelin është e vështirë të bëjë një vlerësim të njëmendtë se si u shkel e drejta për gjykim të drejtë e z. Shala për shkak të “kohës që ka kaluar”. Paneli pajtohet me konstatimin e Panelit të Apelit se z. Shala nuk ka arritur të provojë se si aftësia e tij për t’u mbrojtur dhe për të përgatitur mbrojtjen “u dëmtua rëndë” si pasojë e kohës që ka kaluar.<sup>52</sup>

35. Pavarësisht nga sa më sipër, Paneli i konsideron argumentet e z. Shala si të bazuara në shkeljen thelbësore të procedurave, që cenon të drejtën e tij për gjykim të drejtë, të mbrojtur nga neni 21(2) i Ligjit dhe neni 6 i KEDNJ-së. Paneli do të bëjë përjashtim dhe do të shqyrtojë themelësinë e kësaj pike, duke pasur parasysh rëndësinë që Paneli i jep të drejtës për liri, mbrojtjes së saj, integritetit të procesit dhe të drejtës për gjykim të drejtë.

36. Fillimisht, Paneli rikujton se sipas Kodit Penal të Kosovës, krimet e luftës nuk parashkruhen.<sup>53</sup>

37. Lidhur me ndikimin që koha që ka kaluar ka mbi drejtësinë e procesit, Paneli rikujton konstatimin e Panelit të Apelit se vlerësimi i drejtësisë së procesit mbështetet në faktorë të tjerë, përfshirë vlerësimin “mbështetshmërisë, vlerës provuese dhe, përfundimisht, peshës së provave”.<sup>54</sup> Rrjedhimisht, argumentet e përgjithshme të z. Shala në lidhje atë se “drejtësia e procesit është kompromentuar në mënyrë të pandreqshme nga koha që ka kaluar”<sup>55</sup> janë të pabaza.

38. Rrjedhimisht, pyetja që shtrohet është se a ekzistonin garanci të mjaftueshme në lidhje me vlerësimin e provave të paraqitura gjatë procesit. Në aktgjykimet

<sup>51</sup> Shih Kërkesën e Shalës, para. 13. Shih gjithashtu Kërkesën e Shalës, para. 5, 11.

<sup>52</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 90.

<sup>53</sup> Shih nenin 104(1) të Kodit Penal të Kosovës.

<sup>54</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 92.

<sup>55</sup> Kërkesa e Shalës, para. 8.

përkatëse të tyre, si Trupi Gjykses ashtu dhe Paneli i Apelit theksuan ekzistencën e një morie garancish të tilla dhe mënyrën se si ato u zbatuan në rastin e z. Shala, duke marrë parasysh kohën që ka kaluar që nga kryerja e krimeve.<sup>56</sup>

39. Paneli pajtohet me konstatimin e Panelit të Apelit se çështja gjyqësore *Nikolaou k. Qipros* e GJEDNJ-së, që lidhet me shkeljen e nenit 2 të KEDNJ-së, dhe në të cilën mbështetet z. Shala, nuk mbështet mbrojtjen e tij.<sup>57</sup> Ashtu si para Panelit të Apelit, z. Shala përmend vetëm në mënyrë të përgjithshme “rastet konkrete të mundësive hetimore të humbura gjatë gjithë procesit”.<sup>58</sup> Paneli vëren se z. Shala iu referua vetëm një mundësie hetimore konkrete kur atij iu hoq mundësia të zbulonte, konkretisht të gjente vendndodhjen e një dëshmitari të caktuar, z. Ruzhdi Saramati, në kuadër të mbrojtjes së tij.<sup>59</sup> Megjithatë, z. Shala nuk shpjegoi se çfarë ndikimi, nëse ka, do të kishte pasur ky dëshmitar në çështjen e tij dhe as solli argumente në apel se mungesa e dëshmisë konkrete të këtij personi ishte “fatale” për procesin në çështjen e tij.<sup>60</sup> Rrjedhimisht, z. Shala nuk provoi se vlerësimi i provave prej Trupit Gjykses, i konfirmuar më pas prej Panelit të Apelit, përbën shkelje të të drejtës së tij për gjykim të drejtë.

40. Duke marrë parasysh sa më lart, Paneli konstaton se Pika 1 duhet të rrëzohet.

B. PRANIMI SI PROVA DHE MBËSHTETJA NË DEKLARATAT VETINKRIMINUESE NË SHKELJE TË TË DREJTËS PËR PËRFAQËSIM JURIDIK (PIKA 2)

### 1. Parashtrimet

41. Z. Shala pretendon se Trupi Gjykses dhe Paneli i Apelit gaboi që pranoi si prova dhe u mbështet në deklaratat e tij të viteve 2005 dhe 2007 para Tribunalit Penal

<sup>56</sup> Shih, p.sh., Aktgjykimin, para. 166, 392, 397, 418, 451, 485, 599, 665, 893; Aktgjykimin e Apelit, para. 91-93.

<sup>57</sup> ECtHR, *Nicolaou v. Cyprus*, [no. 29068/10](#), Judgment, 28 May 2020, paras 132-152.

<sup>58</sup> Kërkesa e Shalës, para. 9.

<sup>59</sup> Kërkesa e Shalës, para. 9.

<sup>60</sup> ECtHR, *Nicolaou v. Cyprus*, [no. 29068/10](#), Judgment, 28 May 2020, paras 150.

Ndërkombëar për ish-Jugosllavinë (“TPNJ”), në deklaratën e dhënë policisë belge në vitin 2016 (“deklarata e vitit 2016 në Belgjikë”), në deklaratën e dhënë policisë belge në vitin 2019 (“deklarata e vitit 2019 në Belgjikë”) dhe në deklaratat e dhëna ZPS-së (“deklaratat për ZPS-në”), të cilat, sipas tij, u morën të gjitha pa përfaqësim juridik.<sup>61</sup>

42. Mbrojtja parashtroi se z. Shala i cili kishte shkollim të mangët, ishte i cenueshëm dhe i painformuar, u mor në pyetje pa avokat dhe tregoi mungesë gatishmërie për t’u mbështetur në përkthimin e përkthyesit, çka bëri që deklaratat që iu morën të ishin vetvetiu të pabesueshme dhe të marra në mënyrë të paligjshme.<sup>62</sup> Sipas Mbrojtjes, pretendohet se kjo shkel nenin 6 të KEDNJ-së, nenin 48(7)-(8) të Ligjit, dhe rregullën 193(3)(a) të Rregullores.<sup>63</sup> Z. Shala gjithashtu deklaroi se megjithëse Paneli i Apelit pranoi se në intervistën e vitit 2016 atij iu mohua e drejta për përfaqësim juridik, ky panel megjithatë lejoi që deklaratat e vitit 2016 në Belgjikë të mbeteshin “të disponueshme për t’u marrë parasysh”, duke shpërfillur paligjshmërinë e dukshme të tyre.<sup>64</sup>

43. Z. Shala gjithashtu argumenton se me pranimin e deklaratës së tij të vitit 2016 në Belgjikë u keqinterpretua rrënjësisht doktrina e frutit të pemës së helmatisur, dhe deklaratat e marra në mënyrë të paligjshme u trajtuan si “pa ndikim” thjesht sepse nuk u cituan shprehimisht në arsyetimin e Trupit Gjyqësor.<sup>65</sup> Mbrojtja thekson se deklaratat u bënë pjesë përbërëse e provave të çështjes gjyqësore, konstatimet e bëra u mbështetën në mënyrë vendimtare në to, dhe kompromentuan deklaratat e vitit 2019 në Belgjikë dhe deklaratat për ZPS-në, të cilat u formësuan nga shkelja e bërë më parë.<sup>66</sup>

44. Z. Shala gjithashtu argumenton se Paneli gaboi që nxorri përfundime negative

---

<sup>61</sup> Kërkesa e Shalës, para. 14.

<sup>62</sup> Kërkesa e Shalës, para. 15.

<sup>63</sup> Kërkesa e Shalës, para. 15.

<sup>64</sup> Kërkesa e Shalës, para. 16.

<sup>65</sup> Kërkesa e Shalës, para. 16-18.

<sup>66</sup> Kërkesa e Shalës, para. 17-18.

nga qëndrimi në heshtje i tij dhe që i përdori deklaratat për të "diskredituar" dëshmitë e dëshmitarëve, çka përbën përmbyse të paligjshme të detyrimit të vërtetimit.<sup>67</sup> Mbrojtja thekson se këto deklarata të marra në mënyrë të paligjshme u përdorën për të mbështetur konstatimet kryesore, konkretisht: praninë e z. Shala në fabrikën e metalit në Kukës ("FMK"), takimet e tij me viktimat, pjesëmarrjen e tij në keqtrajtim, rolin dhe pushtetin e tij në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK"), dhe bile dhe mungesën e pendesës së tij – elemente këto që përcaktuan në masë të konsiderueshme verdiktin e fajësisë.<sup>68</sup>

45. Gjithashtu, z. Shala rithekson se pranimi si prova dhe mbështetja në këto deklarata përbënte shkelje thelbësore të të drejtës së tij për mosinkriminim të vetes.<sup>69</sup> Rrjedhimisht, duke pasur parasysh kompromentimin e procesit, Mbrojtja argumenton se i vetmi mjet juridik i përshtatshëm është anulimi i verdikteve të fajësisë dhe rigjykimi, ku të përjashtohen të gjitha deklaratat e marra në mënyrë të paligjshme.<sup>70</sup>

46. ZPS-ja përgjigjet se Pika 2 është një "kolazh" i paqartë i argumenteve të rrëzuara më parë, ku nuk provohet asnjë gabim në Aktgjykimin e Apelit, dhe se në shumë aspekte, është bile e vështirë të thuhet se cilën deklaratë kundërshton z. Shala.<sup>71</sup> Lidhur me pretendimin kryesor në lidhje me të drejtën për të pasur mbrojtës, ZPS-ja argumenton se z. Shala shpërfill konstatimet detyruese të bëra në fazën e apelit.<sup>72</sup> Në ato konstatime u përcaktua se në deklaratat e viteve 2005 dhe 2007 për TPNJ-në dhe në deklaratën e vitit 2019 në Belgjikë, z. Shala u informua për të drejtën e tij për të pasur mbrojtës dhe hoqi dorë në mënyrë të përsëritur prej saj, kështu që, rrjedhimisht, pretendimi për shkelje të të drejtave nuk është vërtetuar.<sup>73</sup>

---

<sup>67</sup> Kërkesa e Shalës, para. 21.

<sup>68</sup> Kërkesa e Shalës, para. 19-23.

<sup>69</sup> Kërkesa e Shalës, para. 21.

<sup>70</sup> Kërkesa e Shalës, para. 26.

<sup>71</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 9.

<sup>72</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 9.

<sup>73</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 11.

47. Sa i përket deklaratës së vitit 2016 në Belgjikë, ZPS-ja argumenton se, në Aktgjykim, Trupi Gjykses nuk u mbështet në të, kështu që edhe në qoftë se ishte bërë gabim me pranimin e deklaratës, z. Shala nuk arriti të tregojë se si ky gabim ndikoi thelbësisht në Aktgjykimin e Apelit.<sup>74</sup> ZPS-ja gjithashtu thekson se z. Shala përsëri nuk ka parasysh konstatimin e bërë në apel se pavarësisht shkeljes “së kufizuar” të të drejtës për të pasur mbrojtës — nuk kishte tregues për mungesë mbështetshmërie apo dëmtim të integritetit të procesit nga pranimi i intervistës.<sup>75</sup>

48. Lidhur me doktrinën e “frutit të pemës së helmatisur” ose pretendimet në lidhje me provat e marra në këtë mënyrë, ZPS-ja parashtron se z. Shala përsërit një argument të rrëzuar tashmë. Konkretisht, z. Shala shpërfill konstatimin e Panelit të Apelit se deklarata e vitit 2016 në Belgjikë ishte marrë në mënyrë të paligjshme dhe se, për rrjedhojë, nuk ka ndonjë “lidhje me pemë dhe fruta” midis deklaratës së vitit 2016 në Belgjikë, deklaratës së vitit 2019 në Belgjikë dhe deklaratave për ZPS-në.<sup>76</sup> ZPS-ja gjithashtu argumenton se edhe në qoftë se z. Shala do të kishte vënë në pah një gabim, ai nuk arrin të provojë se gabimi përbënte shkelje thelbësore të procedurave që ndikon në rezultatin e Aktgjykimit dhe Aktgjykimit të Apelit.<sup>77</sup> Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se Trupi Gjykses nuk u mbështet fare në deklaratën e vitit 2016 në Belgjikë, dhe bile dhe argumentet e ZPS-së të bazuara në këtë deklaratë nuk u përdorën prej Trupit Gjykses kur ky përcakttoi se pjesët përkatëse të deklaratës së vitit 2019 në Belgjikë dhe deklaratave për ZPS-në nuk ishin të besueshme.<sup>78</sup> Bazuar në sa më lart, ZPS-ja argumenton se Pika 2 duhet të rrëzohet në tërësi.<sup>79</sup>

49. Z. Shala përgjigjet se Prokuroria pretendon në mënyrë të pasaktë se z. Shala u shpreh vazhdimisht se hiqte dorë nga e drejta për të pasur mbrojtës, dhe argumenton

---

<sup>74</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 12.

<sup>75</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 13.

<sup>76</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 16.

<sup>77</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 17.

<sup>78</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 22.

<sup>79</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 25.

se çdo heqje dorë e pretenduar nuk ishte as e mbështetur në informacion dhe as e vlefshme, pasi ai nuk u informua asnjëherë për kompleksitetin e situatës së tij apo për domosdoshmërinë e përfaqësimit juridik për një proces të drejtë.<sup>80</sup> Z. Shala gjithashtu argumenton se ZPS-ja minimizon gabimisht shkeljet e procedurave që ndikuan në deklaratën e vitit 2016 në Belgjikë, në deklaratën e vitit 2019 në Belgjikë dhe në deklaratat për ZPS-në.<sup>81</sup> Konkretisht, z. Shala pretendon se mosmarrja parasysh e shkeljeve të të drejtave të Mbrojtjes që ndikojnë në drejtësinë dhe ligjshmërinë e procesit, mund të përbëjë shkelje thelbësore të procedurave.<sup>82</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës Supreme

50. Paneli vë në dukje se z. Shala në përgjithësi pretendon për shkelje të të drejtës së tij për gjykim të drejtë sipas nenit 48(7)-(8) të Ligjit, rregullës 193(3)(a) të Rregullores dhe nenit 6 të KEDNJ-së.<sup>83</sup> Ndonëse z. Shala nuk saktëson llojin e shkeljes, për Panelin është e qartë se me këto argumente ai pretendon për shkelje thelbësore të procedurave. Siç u theksua më lart, pala që kërkon mbrojtje të ligjshmërisë duhet jo vetëm të evidentojë qartë shkeljen e pretenduar të ligjit, por edhe ta faktojë atë. Në rastin e shkeljes së pretenduar të procedurave, pala gjithashtu duhet të provojë se si shkelja e pretenduar ndikoi thelbësisht në aktgjykimin e kundërshtuar.<sup>84</sup>

51. Në këtë aspekt, Paneli rikujton se mund ta rrëzojë si të papranueshme këtë pikë bazuar në mosevidentimin prej z. Shala të shkeljes thelbësore të procedurave të përfshira në Ligj dhe Rregullore. Megjithatë, Paneli do të bëjë përjashtim dhe do të shqyrtojë themelësinë e kësaj pike duke pasur parasysh rëndësinë që Paneli i jep të drejtës për liri, mbrojtjes së saj dhe integritetit të procesit.

52. Paneli vëren se në argumentet e z. Shala ngatërrohen disa aspekte të

---

<sup>80</sup> Kundërpërgjigja e Shalës, para. 4.

<sup>81</sup> Kundërpërgjigja e Shalës, para. 5.

<sup>82</sup> Kundërpërgjigja e Shalës, para. 5.

<sup>83</sup> Kërkesa e Shalës, para. 15.

<sup>84</sup> Vendimi në lidhje me Mustafën, para. 13, 22.

dallueshme, përfshirë ato që lidhen me deklaratat e viteve 2016 dhe 2019 në Belgjikë, deklaratat e viteve 2005 dhe 2007 për TPNJ-në dhe deklaratat për ZPS-në, me detyrimin e vërtetimit, nxjerrjen e përfundimeve negative dhe me rregullat e përgjithshme në lidhje me pranueshmërinë.<sup>85</sup>

53. Paneli vëren se, në thelb, argumentet e z. Shala në lidhje me deklaratat në Belgjikë, ato për TPNJ-në dhe deklaratat për ZPS-në, sillen rreth gabimeve të pretenduara të kryera prej Trupit Gjykses me pranimin e tyre si prova dhe pretendimeve në lidhje me vlerësimin e këtyre deklaratave, çka përbën shkelje të të drejtës së tij për gjykim të drejtë.<sup>86</sup>

54. Paneli fillimisht do të trajtojë argumentet e z. Shala në lidhje me deklaratën e vitit 2016 në Belgjikë. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton standardin e shqyrtimit, ku përcaktohet se “shkelje thelbësore” të procedurave ka kur shkelja ‘ka ndikim juridikisht thelbësor mbi konstatimin gjyqësor’<sup>87</sup>.

55. Paneli vëren se z. Shala ka pranuar se Trupi Gjykses nuk u mbështet në deklaratën e vitit 2016 në Belgjikë për asnjë nga konstatimet e veta.<sup>88</sup> Megjithatë, ai argumenton se thjesht pranimi i kësaj deklarate kompromentoi procesin, pavarësisht nëse u mbështet apo jo Trupi Gjykses në të.<sup>89</sup> Paneli vëren se z. Shala nuk përmend ndonjë dispozitë konkrete të ligjit që u shkel nga pranimi si provë i deklaratës. Në këtë kontekst, Paneli rikujton se nuk ka asnjë rregullë që kërkon përjashtimin e provave të pranuar nga dokumentacioni i provave të çështjes gjyqësore siç argumenton z. Shala.<sup>90</sup> Në fakt, duhet bërë një dallim midis pranimin të provave dhe mbështetjes së panelit në to për aktgjykimin. Këto janë dy koncepte të veçanta që përdoren gjerësisht

---

<sup>85</sup> Kërkesa e Shalës, para. 14, 20-21, 24.

<sup>86</sup> Kërkesa e Shalës, para. 15-26.

<sup>87</sup> Vendimi në lidhje me Veselin, para. 23; Vendimi në lidhje me Krasniqin, para. 24; Vendimi në lidhje me Mustafën, para. 17; Vendimi në lidhje me Gucatit dhe Haradinajn, para. 14.

<sup>88</sup> Kërkesa e Shalës, para. 14. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit, para. 113.

<sup>89</sup> Kërkesa e Shalës, para. 16-17.

<sup>90</sup> Kërkesa e Shalës, para. 17.

në praktikën gjyqësore.

56. Edhe në qoftë se *arguendo* z. Shala do të kishte mundur të vërtetonte se me pranimin si provë të deklaratës së vitit 2016 në Belgjikë kishte ndodhur një shkelje thelbësore e procedurave, ai nuk arriti të provojë se si kjo shkelje ndikoi thelbësisht në ndonjë konstatim gjyqësor. Thjesht fakti se deklarata e vitit 2016 në Belgjikë u pranua si provë dhe, rrjedhimisht, ishte “e disponueshme për t’u marrë parasysh”<sup>91</sup> nga Trupi Gjyqësor, në vetvete nuk tregon me ndonjë konkretësi se cili konstatim gjyqësor u ndikua thelbësisht.

57. Paneli vëren se jurisprudenca e GJEDNJ-së e cituar nga z. Shala, e cila lidhet me doktrinën e “frutit të pemës së helmatisur”, është e lidhur me rrethana ku provat e marra në mënyrë të paligjshme shërbejnë si bazë për verdiktin e fajësisë. Paneli rikujton se Paneli i Apelit i shqyrtoi konkretisht argumentet e z. Shala në këtë aspekt dhe konstatoi se mënyra se si u mor deklarata e vitit 2016 në Belgjikë nuk përbënte rast të “frutit të pemës së helmatisur”.<sup>92</sup>

58. Në fakt, jurisprudenca e GJEDNJ-së në të cilën bazohet z. Shala nuk mbështet argumentin e tij se pranimi i një prove të tillë, pa u mbështetur në të, e bën të padrejtë procesin.<sup>93</sup> Në çështjen gjyqësore të GJEDNJ-së *Panovits k. Qipros*, GJEDNJ-ja, për dhënien e verdiktit të fajësisë, u përqendrua në përdorimin me rëndësi vendimtare të një deklaratë pranuese të kundërshtuar.<sup>94</sup> Ky burim ligjor e dëmton në vend që ta mbështesë pretendimin e z. Shala, pasi konfirmon nevojën për të vërtetuar ndikimin e asaj prove në verdiktin e fajësisë. Në mënyrë të ngjashme, në çështjen gjyqësore *Jaramenko k. Ukrainës*, shkelja ndodhi sepse verdikti i fajësisë u mbështet kryesisht në prova të mara në shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së, ndërsa z. Shala nuk ka treguar se

---

<sup>91</sup> Kërkesa e Shalës, para. 17.

<sup>92</sup> Aktgjykimi i Apelit, para 115-116.

<sup>93</sup> Kërkesa e Shalës, para. 20-26.

<sup>94</sup> ECtHR, *Panovits v. Cyprus*, [no. 4268/04](#), Judgment, 11 March 2009, para. 85.

Trupi Gjykses u mbështet në prova të kompromentuara.<sup>95</sup> Paneli gjithashtu mban parasysh çështjen gjyqësore *Gëfgen k. Gjermanisë*, ku GJEDNJ-ja theksoi se procesi bëhet i padrejtë vetëm kur tregohet se shkelja e të drejtave të personit të dënuar ka pasur ndikim në rezultatin e procesit.<sup>96</sup>

59. Paneli vëren se Paneli i Apelit trajtoi gjerësisht argumentet e z. Shala në lidhje me deklaratën e vitit 2019 në Belgjikë, përfshirë në lidhje me mbështetjen e Trupit Gjykses në të në Aktgjykim.<sup>97</sup> Paneli pajtohet me konstatimin e Panelit të Apelit se deklarata e vitit 2019 në Belgjikë u mor tre vjet të plota pas deklaratës së vitit 2016 në Belgjikë dhe se argumentet e z. Shala se përgjigjet e tij në atë deklaratë “përcaktuan formën e intervistës dhe deklarimeve [të vitit 2019]”, janë thjesht spekulative.<sup>98</sup> Në lidhje me deklaratën e vitit 2019 në Belgjikë, Paneli i Apelit gjithashtu konstatoi se z. Shala hoqi shprehimisht dhe vullnetarisht dorë nga e drejta e tij për të pasur mbrojtës kur dha deklaratën e tij dhe, rrjedhimisht, tani nuk mund të kërkojë të ushtrojë në mënyrë prapavepruese të drejtën e tij për mosinkriminim të vetes për të penguar pranimin si provë të kësaj deklarate.<sup>99</sup>

60. Bazuar në sa më lart, Paneli është i mendimit se z. Shala nuk ka analizuar në mënyrë të njëmendtë konstatimet e Panelit të Apelit ose nuk ka treguar si gaboi Paneli i Apelit në konstatimet e veta në lidhje me deklaratat e viteve 2016 dhe 2019 në Belgjikë. Rrjedhimisht, rrëzohen argumentet e z. Shala në lidhje me këtë aspekt.

61. Lidhur me deklaratat për TPNJ-në, Paneli vëren se Paneli i Apelit konstatoi se z. Shala ishte informuar si duhet për të gjitha të drejtat e tij gjatë intervistës me prokurorët e TPNJ-së në vitin 2005 dhe në vitin 2007, përfshirë se kishte të drejtën për

<sup>95</sup> ECtHR, *Yaremenko v. Ukraine*, [no. 32092/02](#), Judgment, 12 September 2008, paras 66-67.

<sup>96</sup> ECtHR, *Gëfgen v. Germany*, [no. 2297/05](#), Judgment, 1 June 2010, para. 178.

<sup>97</sup> Shih, p.sh., Aktgjykimin e Apelit, para. 119-121.

<sup>98</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 116; Kërkesa e Shalës, para. 18.

<sup>99</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 117-118.

përfaqësim juridik sipas zgjedhjes së tij.<sup>100</sup> Paneli i Apelit në atë vendim trajtoi edhe argumentet e z. Shala në lidhje me gjendjen mendore të tij dhe aftësinë për të kuptuar si duhet pasojat e vendimit të vet për të mos pasur të pranishëm një avokat dhe konstatoi se z. Shala nuk provoi se Trupi Gjykses kishte gabuar në arsyetim dhe në pranimin e deklaratave për TPNJ-në.<sup>101</sup>

62. Paneli vëren se z. Shala nuk i referohet Vendimit të Apelit mbi Deklaratat e Mëparshme, as jep argumente se si Trupi Gjykses apo Paneli i Apelit shkelën thelbësisht procedurat në këtë aspekt, përfshirë pranimin si prova të deklaratave për TPNJ-në dhe mbështetjen në to për konstatimet e Trupit Gjykses. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon argumentet e Shalës në lidhje me deklaratat për TPNJ-në.

63. Duke marrë parasysh sa më lart, Paneli konstaton se z. Shala nuk ka provuar se Paneli i Apelit gaboi në vlerësimin e Aktgjykimit, dhe as se kjo përbënte shkelje thelbësore të procedurave.

64. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikën 2 në tërësi.

## C. SHKELJE E PARIMIT TË LIGJSHMËRISË (PIKA 3)

### 1. Parashtrimet

65. Z. Shala parashtron se verdikti i fajësisë së tij për ndalim arbitrar si krim lufte në një konflikt të armatosur jondërkombëtar dhe sipas formës së përgjegjësisë penale të Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët ("NKP"), shkel parimin e ligjshmërisë, pasi as vepra penale dhe as forma e përgjegjësisë penale nuk përbënin vepra penale sipas Ligjit të Kosovës ose të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën kur pretendohet se u kryen.<sup>102</sup> Në veçanti, ai argumenton se verdikti i fajësisë së tij, në këtë aspekt, shkel

<sup>100</sup> Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës, KSC-BC-2020-04/IA006, Vendim mbi Apelin e Shalës kundër Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë, 5 maj 2023 ("Vendimi i Apelit mbi Deklaratat e Mëparshme"), para. 46-53, 59, 62-69.

<sup>101</sup> Vendimi i Apelit mbi Deklaratat e Mëparshme, para. 52-54, 67-69.

<sup>102</sup> Kërkesa e Shalës, para. 27.

nenin 7 të KEDNJ-së, nenin 33 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 15 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike ("KNDCP").<sup>103</sup>

66. Neni 7(1) i KEDNJ-së kërkon që vepra penale të jetë e përcaktuar në ligj. Z. Shala pretendon se Paneli e zgjeroi në mënyrë të papërshtatshme fushëveprimin e nenit 16(1)(a) të Ligjit për DHSK-në sikur ky përfshinte përgjegjësinë penale për NKP-në, pavarësisht se në ligj për këtë nuk ka asnjë referencë.<sup>104</sup> Mbrojtja gjithashtu argumenton se duke pasur parasysh shkollimin minimal të z. Shala dhe mospasjen e një pozite eprore, kjo përgjegjësi penale nuk ishte as e parashikueshme prej tij dhe as e arritshme për të.<sup>105</sup>

67. Z. Shala gjithashtu argumenton se verdikti i fajësisë së tij për ndalim arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar është i paligjshëm, sepse në nenin 14(1)(c) të Ligjit për DHSK-në jepet një listë shteruese e krimeve të luftës në konfliktet e armatosura jondërkombëtare, ku nuk përfshihet ndalimi arbitrar.<sup>106</sup> Sipas z. Shala, ndalimi arbitrar gjithashtu nuk përbënte vepër penale në vitin 1999.<sup>107</sup> Ai argumenton se Trupi Gjykses dhe Paneli i Apelit u mbështetën në garanci procedurale dhe përkufizime që nuk ekzistonin në kohën në fjalë, duke shkelur kështu kriteret e disponueshmërisë dhe parashikueshmërisë të nenit 7(1) të KEDNJ-së.<sup>108</sup> Si rezultat, z. Shala pretendon se panelet bënë penalizim prapaveprues, që përbën "shkelje thelbësore të ligjit" sipas nenit 48(7)-(8) të Ligjit dhe rregullës 193 të Rregullores.<sup>109</sup>

68. ZPS-ja përgjigjet se në Pikën 3, ku vihet në pikëpyetje ligjshmëria e NKP-së dhe e ndalimit arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar, thjesht përsëriten argumente të rrëzuara tashmë nga disa panele të DHSK-së, dhe shpërfillet

---

<sup>103</sup> Kërkesa e Shalës, para. 27.

<sup>104</sup> Kërkesa e Shalës, para. 28.

<sup>105</sup> Kërkesa e Shalës, para. 28.

<sup>106</sup> Kërkesa e Shalës, para. 29.

<sup>107</sup> Kërkesa e Shalës, para. 29.

<sup>108</sup> Kërkesa e Shalës, para. 29.

<sup>109</sup> Kërkesa e Shalës, para. 30.

jurisprudenca e rrënjosur, përfshirë qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të normave të së drejtës zakonore ndërkombëtare.<sup>110</sup> Lidhur me parashikueshmërinë e NKP-së si formë e përgjegjesisë penale, ZPS-ja argumenton se z. Shala paraqet “argumente të pabaza” (ndër to rrethana personale si shkollimi dhe grada) që nuk mund të zëvendësojnë jurisprudencën e qëndrueshme dhe të arsyetuar që konfirmon ligjshmërinë e tyre.<sup>111</sup> Në lidhje me ndalimin arbitrar, ZPS-ja argumenton se z. Shala përsëri paraqet “argumente boshe” kundër statusit në të drejtën zakonore ndërkombëtare të kësaj vepre penale dhe argumenton se baza zakonore e saj është “jashtë çdo diskutimi të arsyeshëm” dhe është konfirmuar vazhdimisht prej paneleve të Dhomave të Specializuara në bazë të praktikës së shteteve dhe të *opinio juris*.<sup>112</sup> ZPS-ja arrin në përfundimin se “qartazi nuk ka shkelje të së drejtës penale” dhe Pika 3 duhet të rrëzohet.<sup>113</sup>

69. Z. Shala përgjigjet se Prokuroria keqinterpreton burimin e garancive procedurale në lidhje me ndalimin arbitrar, pasi mbështetet në referencën e Trupit Gjykses në Vendimin e Konfirmimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe në studimin e vitit 2005 të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (“KNKK”), teksa shpërfill aspektin kryesor se, para vitit 1999, nuk ka pasur praktikë të rrënjosur shtetërore që e konsideronte krim ndalimin arbitrar sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare.<sup>114</sup> Z. Shala argumenton se këtë ndalim KNKK-ja për herë të parë e artikuloi vetëm në vitin 2005, se në kohën për të cilën është fjala nuk ekzistonte një studim i përgjithshëm apo normë zakonore, dhe se praktika shtetërore e cituar në studimin e KNKK-së është e paqartë, shpesh i përket periudhës pas vitit 1999 dhe në të nuk përcaktohet qartë penalizimi që zbatohet për konfliktet e armatosura

---

<sup>110</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 27.

<sup>111</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 28.

<sup>112</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 29.

<sup>113</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 32.

<sup>114</sup> Kundërpërgjigjja e Shalës, para. 6-7.

ndërkombëtare dhe për ato jondërkombëtare.<sup>115</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës Supreme

70. Fillimisht, Paneli vëren se, në këtë pikë, z. Shala paraqet dy pretendime të ndryshme, konkretisht në lidhje me formën e përgjegjësisë penale të NKP-së dhe krimin e ndalimit arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar.<sup>116</sup> Paneli vëren se argumentet e z. Shala në lidhje me ndalimin arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar në thelb parashtrohen sërish në Pikën 7.<sup>117</sup> Rrjedhimisht, Paneli tani do të trajtojë vetëm argumentet e tij në lidhje me NKP-në të paraqitura në Pikën 3 dhe më pas do të trajtojë argumentet e tij në lidhje me ndalimin arbitrar së bashku me Pikën 7.

71. Lidhur me formën e përgjegjësisë penale të NKP-së, Paneli rikujton se sipas nenit 48(7)(a) të Ligjit, pala që kërkon mbrojtjen e ligjshmërisë duhet të ngrejë pretendim për shkelje të të drejtës penale të përcaktuar në këtë Ligj dhe në Rregullore.

72. Paneli vëren se z. Shala pretendon për shkelje të të drejtës penale, konkretisht të nenit 16(1)(a) të Ligjit.<sup>118</sup> Në lidhje me këtë, Paneli rikujton se në këtë nen përcaktohen format e përgjegjësisë penale individuale që zbatohen në Dhomat e Specializuara. Z. Shala pretendon se interpretimi prej Trupi Gjykues dhe Panelit të Apelit i nenit 16(1)(a) të Ligjit sikur në të përfshihet forma e përgjegjësisë penale e NKP-së, shkon përtej kufijve ligjorë të kësaj dispozite, duke shkelur kështu parimin e ligjshmërisë të përcaktuar në nenin 7 të KEDNJ-së dhe në nenin 33 të Kushtetutës.<sup>119</sup> Në këtë kontekst, Paneli mban parasysh argumentin e z. Shala se kjo formë e përgjegjësisë penale nuk ishte formë e pranuar e përgjegjësisë penale individuale sipas Ligjit. Për rrjedhojë, argumentohet se sjellja për të cilën u shpall fajtor i akuzuari nuk

<sup>115</sup> Kundërpërgjigjja e Shalës, para. 7.

<sup>116</sup> Kërkesa e Shalës, para. 27.

<sup>117</sup> Shih Kërkesën e Shalës, para. 52, 53-59, 67.

<sup>118</sup> Kërkesa e Shalës, para. 28.

<sup>119</sup> Kërkesa e Shalës, para. 27-28.

ishte vepër penale sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Pika 3 është e pranueshme dhe do të trajtojë themelësinë e saj.

73. Z. Shala argumenton se Paneli i Apelit shkeli parimin e ligjshmërisë sepse NKP-ja nuk ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare ose e legjislacionit të Kosovës në kohën kur u kryen krimet.<sup>120</sup> Përveç argumentit se NKP-ja nuk përmendet shprehimisht në Ligj, z. Shala nuk jep asnjë referencë në lidhje me zbatueshmërinë e NKP-së sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së krimeve.

74. Paneli rikujton se Trupi Gjykses I e shpalli fajtor z. Shala për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme në kontekstin e konfliktit të armatosur jondërkombëtar vetëm sipas formës së përgjegjesisë penale të NKP I-shit,<sup>121</sup> dhe jo sipas asaj të NKP II-shit apo NKP III-shit. Rrjedhimisht, në analizën e vet Paneli do të përqendrohet vetë në shkeljen e mundshme të parimit të ligjshmërisë në lidhje me NKP I-shin sipas kësaj Pike.

75. Lidhur me nenin 16(1)(a) të Ligjit dhe përputhshmërinë e tij me parimin e ligjshmërisë, Paneli i Gjykatës Supreme rikujton dhe pajtohet me analizën dhe konstatimet e bëra më parë prej Panelit të Apelit se Ligji e përcakton NKP-në si formë kryerje sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit,<sup>122</sup> dhe se NKP I është formë e përgjegjesisë penale sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së krimeve,<sup>123</sup> që ishte e disponueshme dhe e parashikueshme për z. Shala.<sup>124</sup>

76. Në këtë kontekst, Paneli rikujton konstatimin e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("DHSGJK") se normat ligjërishit detyruese të së drejtës zakonore ndërkombëtare në lidhje me krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, dhe format e përgjegjesisë penale, janë të zbatueshme drejtpërdrejt sipas Kushtetutës së

---

<sup>120</sup> Kërkesa e Shalës, para. 27.

<sup>121</sup> Aktgjykimi, para. 1036.

<sup>122</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 175 dhe poshtëshënimet 391-393.

<sup>123</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 175 dhe poshtëshënimi 392

<sup>124</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 175 dhe poshtëshënimi 393.

Kosovës.<sup>125</sup> Paneli mban parasysh jurisprudencën e DHSGJK-së, ku konstatohet se e drejta zakonore ndërkombëtare ka përparësi ndaj legjislacionit vendor, në përputhje me kuadrin ligjor të Kosovës dhe Kushtetutën e Kosovës.<sup>126</sup>

77. Gjithashtu, sipas nenit 3(3) të Ligjit, për përcaktimin e të drejtës zakonore ndërkombëtare Paneli orientohet nga jurisprudenca e tribunalëve *ad hoc*.<sup>127</sup>

78. Mbi këtë bazë, Paneli vëren se NKP I ka qenë e përcaktuar qartë si formë e pranuar e përgjegjësisë penale sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare në vitin 1998, e cila është zbatuar rregullisht nga disa gjykata dhe tribunale ndërkombëtarë dhe të ndërkombëtarizuar.<sup>128</sup> Gjithashtu, Paneli vëren se NKP I, që mishëron përkufizimin e bashkëkryerjes brenda kodeve penale në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve si dhe atyre aktualisht në fuqi në Kosovë,<sup>129</sup> është zbatuar nga gjykatat e Kosovës kur kanë

---

<sup>125</sup> *Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës*, KSC-CC-2022-16/F00004, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me të Drejtat Themelore të tij të Garantuara nga Neni 7 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 6 korrik 2022, para. 61-72 (“Vendimi i DHSGJK-së mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës”).

<sup>126</sup> Vendimi i DHSGJK-së mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës; *Prokurori i Specializuar k. Thaçit dhe të tjerëve.*, KSC-CC-2022-14/F00009, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Jakup Krasniqit në lidhje me Ligjshmërinë e Akuzës së Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët dhe Kërkesën Referuese të Kadri Veselit në lidhje me Vendimin e Panelit të Apelit për Kundërshtimet ndaj Juridiksionit të Dhomave të Specializuara, 13 qershor 2022, para. 69; neni 31 i Kodit Penal të Kosovës. Shih gjithashtu nenin 18 të Kodit Penal të RFSJ-së.

<sup>127</sup> Shih nenin 3(3) të Ligjit; KSC-BC-2020-04/IA002/F00010, Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Mocionin që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 11 shkurt 2022, para. 19; *Prokurori i Specializuar k. Thaçit dhe të tjerëve.*, KSC-BC-2020-06/IA009/F00030, Vendim mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 23 dhjetor 2021 (“Vendimi i Apelit në lidhje me Juridiksionin në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*”), para. 152.

<sup>128</sup> Shih ICTY, *Prosecutor v. Tadić*, Judgment, IT-94-1-A, 15 July 1999, para. 220; ICTY, *Prosecutor v. Milutinović et al.*, Decision on Dragoljub Ojdanić’s Motion Challenging Jurisdiction – Joint Criminal Enterprise, IT-99-37-AR72, 21 May 2003, para. 17; ICTR, *Prosecutor v. Elizephan Ntakirutimana and Gérard Ntakirutimana*, Judgment, ICTR-96-10-A and ICTR-96-17-A, 13 December 2004, paras 461-468; ICTR, *Prosecutor v. Simba*, Judgment, ICTR-01-76-A, 27 November 2007, paras 243-255; ICTR, *Prosecutor v. Karemera and Ngirumpatse*, Judgment, ICTR-98-44-A, 29 September 2014, para. 110; SCSL, *Prosecutor v. Taylor*, Judgment, SCSL-03-01-T, 18 May 2012, paras 458, 466; SCSL, *Prosecutor v. Sesay et al.*, Judgment, SCSL-04-15-A, 26 October 2009, paras 397-400. Në lidhje me NKP I-shin, shih ECCC, *Prosecutor v. Samphân and Chea*, Appeal Judgment, 002/19-09-2007-ECCC/SC, 23 November 2016, para. 810.

<sup>129</sup> Shih nenin 22 të Kodit Penal të RFSJ-së; neni 31 të Kodit Penal të Kosovës.

shpallur fajtorë individë për krime ndërkombëtare.<sup>130</sup> Rrjedhimisht, nuk mund të ketë asnjë diskutim në lidhje me përgjegjësinë për NKP I-shin si formë e përcaktuar qartë e përgjegjesisë penale sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare.

79. Lidhur me nëse NKP-ja ishte e parashikueshme apo e disponueshme për z. Shala duke pasur parasysh shkollimin minimal të tij dhe mungesën e rolit epror, dhe se, për këtë arsye, verdikti i fajësisë së tij shkel parimin e ligshmërisë,<sup>131</sup> Paneli pajtohet me konstatimin e Panelit të Apelit se, për vlerësimin e parashikueshmërisë mund të jenë të rëndësishëm faktorë të tillë si shkollimi i të akuzuarit, grada ose qasja në informacion, por nuk janë vendimtarë.<sup>132</sup> Siç ka konstatuar Paneli i Apelit, parashikueshmëria vlerësohet në mënyrë objektive, dhe mungesa e pozitës zyrtare, shkollimi minimal apo qasja e kufizuar në informacion publik, në vetvete, nuk mund të përjashtojnë përgjegjësinë penale kur Ligji në fuqi ishte mjaftueshëm i disponueshëm dhe i parashikueshëm në kohën për të cilën flitet.<sup>133</sup>

80. Duke marrë parasysh sa më lart, Paneli është bindur se Paneli i Apelit nuk shkeli të drejtën penale kur konfirmoi konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, të Trupit Gjyqësor, të DHSGJK-së dhe përfundimet e veta dhe kur përcaktoi se NKP I ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën që përfshijnë akuzat, se e drejta zakonore ndërkombëtare ishte drejtpërdrejt e zbatueshme në Dhomat e Specializuara dhe ka përparësi ndaj kuadrit kushtetues të Kosovës, dhe se

---

<sup>130</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 812. Shih gjithashtu Gjykata Supreme e Kosovës, *AP-KZ 89/2010*, Aktgjykim, 26 janar 2011, para. 114-117; Kosovë, Gjykata Themelore e Prishtinës, *P 448/2012*, Aktgjykim, 7 qershor 2013, f. 1-2; Gjykata e Apelit e Kosovës, *PAKR 440/13*, Aktgjykim, 11 gusht 2015, f. 1-2, 14, 18-19; Gjykata Supreme e Kosovës, *Plm.Kzz 18/2016*, Aktgjykim, 13 maj 2016, para. 69-74; Gjykata e Apelit e Kosovës, *PAKR 271/13*, Aktgjykim, 30 janar 2014, para. 34-41; Gjykata Supreme e Kosovës, *PA II 3/2014*, Aktgjykim, 7 gusht 2014, para. xlii-xliv; Gjykata Supreme e Kosovës, *Ap.-Kz No. 371/2008*, Aktgjykim, 10 prill 2009, f. 14-16, 46-47, 63-64, 82-83; Gjykata e Apelit e Kosovës, *PAKR 966/2012*, Aktgjykim, 11 shtator 2013, para. 74; Gjykata e Apelit e Kosovës, *P. nr. 122/2014*, Aktgjykim, 22 qershor 2017, para. 1.7 (f. 11-12); Kosovë, Gjykata Themelore e Mitrovicës, *P.nr. 64/12*, Aktgjykim, 12 shtator 2013, f. 37; Gjykata e Apelit e Kosovës, *PAKR 55/14*, Aktgjykim, 29 tetor 2014, f. 1-3, 22.

<sup>131</sup> Kërkesa e Shalës, para. 28.

<sup>132</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 177.

<sup>133</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 177; Vendimi mbi Apelin e Shalës lidhur me Juridiksionin, para. 36.

përgjegjësia penale për NKP I-shin ishte mjaftueshëm e disponueshme dhe e parashikueshme për z. Shala.

81. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikën 3 sa i përket NKP-së si formë e përgjegjësisë penale për krimin e ndalimit arbitrar.

D. INFORMIMI I PAMJAFTUESHËM MBI AKUZAT E PROKURORISË REZULTOI NË VERDIKTE TË GABUARA FAJËSIE (PIKA 4)

### 1. Parashtrimet

82. Z. Shala argumenton se Trupi Gjykues e shpalli fajor në bazë të një aktakuze të mangët, ku nuk identifikoheshin as anëtarët e NKP-së së pretenduar dhe as viktimat e “veprave penale” të pretenduara.<sup>134</sup> Z. Shala pretendon se Paneli i Apelit e pranoi këtë mungesë konkretësie, e cila i hoqi Mbrojtjes mundësinë reale për të hetuar dhe për t’iu përgjigjur akuzave, dhe shkeli nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 30 të Kushtetutës së Kosovës.<sup>135</sup> Z. Shala argumenton se mospërmendja me emra e viktimave ose e anëtarëve të NKP-së, e pengoi të akuzuarin të organizonte mbrojtje të efektshme.<sup>136</sup> Sipas z. Shala, përmendja në aktakuzë vetëm e “zyrtarëve” të paidentifikuar dhe e viktimave pa emra, nuk përmbushi standardet minimale ndërkombëtare të argumentimit të akuzave, çka faktikisht zgjeroi kuadrin e akuzave të Prokurorisë.<sup>137</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykues shtoi numrin e viktimave nga nëntë në 18 individë.<sup>138</sup>

83. Z. Shala gjithashtu pretendon se nëntë viktimat shtesë nuk përfshiheshin në akuzat e paraqitura fillimisht, çka krijoi për z. Shala një mundësi të re për shpalljen fajtor të tij pa njoftim paraprak.<sup>139</sup> Si rezultat, Mbrojtja parashtron se ajo u la në padijeni

---

<sup>134</sup> Kërkesa e Shalës, para. 31.

<sup>135</sup> Kërkesa e Shalës, para. 31.

<sup>136</sup> Kërkesa e Shalës, para. 32.

<sup>137</sup> Kërkesa e Shalës, para. 31.

<sup>138</sup> Kërkesa e Shalës, para. 33.

<sup>139</sup> Kërkesa e Shalës, para. 34.

të plotë dhe nuk u njoftua se z. Shala faktikisht po gjykohej për krime që përfshinin 18 viktima.<sup>140</sup> Kjo përbënte një transformim të palejueshëm të akuzave të Prokurorisë dhe shkeli të drejtën e tij për gjykim të drejtë.<sup>141</sup> Mbrojtja thekson se kjo çështje është jotipike duke pasur parasysh numrin e kufizuar të viktimave për të cilat nevojitet konkretësi më e madhe, dhe se është e padrejtë që ai të dënohet për vepra penale që pretendohet se janë kryer ndaj nëntë individëve të tjerë, në lidhje me të cilët ndaj Shalës nuk është ngritur asnjë akuzë në Aktakuzë.<sup>142</sup> Sipas Mbrojtjes, mungesa e njoftimit dhe saktësisë i mohoi z. Shala kohën, mjetet dhe qartësinë e mjaftueshme për të përgatitur Mbrojtjen, çka përbën shkelje thelbësore të procedurave sipas nenit 48(7) të Ligjit dhe rregullës 193 të Rregullores.<sup>143</sup>

84. ZPS-ja përgjigjet se në argumentet e tij në lidhje me të dhënat konkrete të anëtarëve të tjerë të NKP-së, z. Shala përsërit argumente që janë rrëzuar tashmë në apel dhe se ai nuk trajton Aktgjykimin e Apelit, çka e bën të papranueshme kërkesën.<sup>144</sup> ZPS-ja gjithashtu parashtrohet se z. Shala nuk shpjegon ndonjë gabim në Aktgjykim dhe në arsyetimin e Panelit të Apelit, se përsëritimi i anëtarëve të NKP-së nuk ishte palejueshmërisht i mjegullt, dhe se z. Shala nuk evidenton asnjë gabim ligjor në konstatimet e Trupit Gjykoës në lidhje me anëtarët e NKP-së.<sup>145</sup> ZPS-ja gjithashtu thekson se Paneli i Apelit tashmë e ka hedhur poshtë në një vendim të arsyetuar pretendimin për dëmtim të tij, ku, ndër të tjera, konstatoi se në Aktakuzë jepej informacion i qartë se, përveç atyre të përmendur me emra, NKP-ja kishte dhe anëtarë të tjerë, dhe se Aktakuza nuk ishte e mangët.<sup>146</sup>

85. ZPS-ja gjithashtu argumenton se z. Shala thjesht nuk pajtohet me konstatimet e Panelit të Apelit në lidhje me dëmin e shkaktuar ndaj 18 viktimave, në vend të nëntë

---

<sup>140</sup> Kërkesa e Shalës, para. 35.

<sup>141</sup> Kërkesa e Shalës, para. 35.

<sup>142</sup> Kërkesa e Shalës, para. 36.

<sup>143</sup> Kërkesa e Shalës, para. 37.

<sup>144</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 33.

<sup>145</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 34.

<sup>146</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 34.

viktimave të përmendura në Aktakuzë.<sup>147</sup> Sipas ZPS-së, Paneli i Apelit konstatoi me të drejtë se aktakuza ishte korrigjuar dhe se z. Shala kishte marrë “informacion të qartë, përputhës dhe në kohë se ai akuzohej në lidhje me të paktën 18 viktima”.<sup>148</sup>

86. Z. Shala përgjigjet se Prokuroria nuk merr parasysh dëmin e shkaktuar nga mospërfshirja në Aktakuzë e anëtarëve kyç të pretenduar të NKP-së, dhe argumenton se në qoftë se njerëz si z. Fatmir Limaj dhe z. Osman Kryeziu do të ishin identifikuar si pjesëmarrës në NKP, Mbrojtja mund të kishte kryer hetime të fokusuara dhe të përshtaste strategjinë e vet sipas këtyre rrethanave, veçanërisht duke pasur parasysh rolin e z. Kryeziu si dëshmitar i Prokurorisë.<sup>149</sup> Mbrojtja gjithashtu kundërpërgjigjet se mospërfshirja e figurave të tilla të shquara të UÇK-së, të cilat Prokuroria i njhte mirë, shkeli të drejtën për gjykim të drejtë të z. Shala, dhe se, po ashtu, Prokuroria nuk trajton argumentet e Mbrojtjes në lidhje me të dhënat konkrete të viktimave, duke argumentuar gabimisht se përmendja e aspekteve faktike përbën njohje ose pranim të zgjerimit të palejueshëm të akuzave.<sup>150</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës Supreme

87. Fillimisht, Paneli vëren se z. Shala nuk vë në pah ndonjë shkelje thelbësore të një procedure konkrete në Ligj dhe Rregullore, por vetëm përmend në mënyrë të përgjithshme nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 30 të Kushtetutës.<sup>151</sup>

88. Paneli gjykon se argumentet e z. Shala mund të kuptohen se thirrje për zbatimin e nenit 6(3)(a) të KEDNJ-së, që ka të bëjë me informimin për akuzat. Paneli vëren se, në mënyrë të ngjashme, në nenin 21(4)(a) të Ligjit parashikohet e drejta e të akuzuarit për t’u njoftuar për akuzat kundër tij. Rrjedhimisht, Paneli do të shqyrtojë themelësinë e kësaj pike duke pasur parasysh rëndësinë që Paneli i jep të drejtës për liri, mbrojtjes

---

<sup>147</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 36.

<sup>148</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 41. Shih gjithashtu Përgjigjen e ZPS-së, para. 37-40, 42.

<sup>149</sup> Kundërpërgjigjja e Shalës, para. 8.

<sup>150</sup> Kundërpërgjigjja e Shalës, para. 8-9.

<sup>151</sup> Kërkesa e Shalës, para. 31-37.

së saj dhe integritetit të procesit.

89. Paneli vëren se z. Shala nuk pajtohet me Aktgjykimin e Apelit dhe argumenton se Paneli i Apelit shkeli të drejtën procedurale, por ai nuk trajton konstatimet e Panelit të Apelit në lidhje me pretendimet për mangësi të aktakuzës dhe, çka është më e rëndësishme, nuk trajton analizën e zgjeruar të tij dhe konstatimin e bërë në fund se mangësitë në aktakuzë ishin ndrequr.<sup>152</sup>

90. Konkretisht, Paneli vëren se Paneli i Apelit arriti në përfundimin se Trupi Gjykues gaboi që nuk konstatoi se Aktakuza kishte mangësi sa i përket numrit të viktimave të përfshira në të.<sup>153</sup> Paneli i Apelit më pas konstatoi se mangësia në aktakuzë mund të ndreqej, pasi shtimi i nëntë viktimave “nuk përbën[te] akuzë të re dhe as nuk rezultoi[i] në transformim rrënjësor të akuzave të ZPS-së kundër Shalës”.<sup>154</sup> Paneli i Apelit gjithashtu theksoi se shprehja “së paku” nëntë viktima në aktakuzë, ishte tregues i qartë se z. Shala mund të përballej me përgjegjësi penale për më shumë viktima.<sup>155</sup> Në këtë aspekt, Paneli i Apelit vuri në dukje se në dosjen paraprake, deklaratat hyrëse dhe në të gjitha parashtrimet e saj gjatë gjykimit, ZPS-ja iu referua 18 viktimave.<sup>156</sup> Paneli i Apelit gjithashtu analizoi dijeninë e Shalës për 18 viktimat gjatë gjithë procesit dhe konstatoi se ai kishte pasur dijeni për ekzistencën e tyre.<sup>157</sup>

91. Paneli vëren se z. Shala nuk trajton asnjë nga analizat e Panelit të Apelit në lidhje me mangësitë në aktakuzë dhe mënyrën se si u ndreqën ato, dhe as vë në dukje gabime në vlerësimin e Panelit të Apelit në këtë aspekt. Paneli pajtohet me përfundimin e Panelit të Apelit se mungesa e konkretësisë në aktakuzë ishte ndrequr, çka i mundësoi z. Shala të përgatiste një mbrojtje të njëmendtë<sup>158</sup> dhe se zotit Shala i

---

<sup>152</sup> Shih Kërkesën e Shalës, para. 31-37.

<sup>153</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 189-193.

<sup>154</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 195.

<sup>155</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 195.

<sup>156</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 197.

<sup>157</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 198.

<sup>158</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 197.

ishte dhënë “informacion i qartë, përputhës dhe në kohë” se ai akuzohej në lidhje me 18 individë.<sup>159</sup>

92. Në mënyrë të ngjashme, Paneli i Apelit trajtoi gjerësisht argumentet e z. Shala në lidhje me anëtarët e NKP-së dhe mopërmendjen me emra të viktimave.<sup>160</sup> Paneli vëren se z. Shala deklaroi vetëm në mënyrë të përgjithshme se mangësitë në aktakuzë në lidhje me anëtarët e NKP-së dhe emrat e viktimave nuk u ndreqën asnjëherë, por nuk tregon ndonjë konstatim konkret të Panelit të Apelit, nuk trajton analizën e zgjeruar të kryer prej tij dhe as citon jurisprudencë apo burime të tjera në mbështetje të pretendimit të tij të përgjithshëm.<sup>161</sup>

93. Për rrjedhojë, Paneli konstaton se z. Shala nuk provon se është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë në këtë aspekt. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikën 4.

E. PADREJTËSIA QË REZULTOI NGA KOMPROMENTIMI I DËSHMIVE TË DËSHMITARËVE TË PROKURORISË (PIKA 5)

### 1. Parashtrimet

94. Z. Shala argumenton se Trupi Gjykses gaboi që pranoi si prova dëshmitë e dëshmitarëve të Prokurorisë, të cilat, siç pretendon ai, ishin dukshëm të kompromentuara, pasi ata shkëmbyen mendime në lidhje me aspektet e çështjes gjyqësore.<sup>162</sup> Mbrojtja argumenton se Paneli gaboi që pranoi dëshmitë e anëtarëve të familjes së W04733-shit, pavarësisht treguesve të qartë të koordinimit mes tyre, përfshirë ngjashmëritë e habitshme në rrëfimet e tyre, çka lë të kuptohet se ata i kishin përgatitur bashkë paraprakisht dëshmitë e tyre.<sup>163</sup>

95. Gjithashtu, z. Shala argumenton se Trupi Gjykses hodhi poshtë në mënyrë të

<sup>159</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 199.

<sup>160</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 209-235.

<sup>161</sup> Shih Kërkesën e Shalës, para. 31-37.

<sup>162</sup> Kërkesa e Shalës, para. 38.

<sup>163</sup> Kërkesa e Shalës, para. 39.

paarsyeshme mundësinë që TW4-08-ës të ishte influencuar për shkak të pranisë së tij gjatë një interviste me dëshmitarin e Prokurorisë W04733.<sup>164</sup> Mbrojtja gjithashtu argumenton se ndërsa Paneli pati një qasje të butë ndaj pranimi si prova të dëshmisë së W04733-shit dhe familjarëve të tij, ai në të njëjtën kohë shqyrtoi me imtësi dëshmitë e dëshmitarëve të Mbrojtjes dhe i trajtoi ato me kujdes pa ndonjë arsye.<sup>165</sup> Sipas z. Shala, ky qëndrim kontradiktor përbën zbatim të standardeve të dyfishta dhe pasqyron një vlerësim të paarsyeshëm dhe selektiv.<sup>166</sup>

96. Gjithashtu, z. Shala parashtron se Trupi Gjykses nuk vlerësoi si duhet provat e shumta që tregonin se dëshmitarë kyç të Prokurorisë kishin folur mes tyre për aspektet e diskutueshme, duke kompromentuar kështu dëshmitë e tyre.<sup>167</sup> Mbrojtja vëren se dëshmitarët W01448, TW4-01, TW4-10 dhe TW4-04 pranuan se ishin takuar, kishin mbajtur kontakte, ose kishin diskutuar pas luftës ngjarje me rëndësi kyçe për çështjen gjyqësore, si ndalimi në FMK dhe ngjarjet në Kukës, tregues të qartë këta të linjëzimit të dëshmimeve të tyre.<sup>168</sup> Mbrojtja gjithashtu thekson se TW4-04 dhe TW4-01 kishin folur mes tyre për aspekte të diskutueshme në disa raste, dhe se të dy panelet nuk morën parasysh se TW4-01 dhe TW4-10 ishin miq që kishin diskutuar hapur mes tyre për aspekte kyçe, ndër to dhe vdekja e një viktime.<sup>169</sup> Sipas z. Shala, mostrajtimi prej Panelit i këtyre dëshmimeve të kompromentuara me kujdesin e nevojshëm dhe vijimi i mbështetjes në masë të konsiderueshme në to, ishte gabim i rëndë që dëmtoi drejtësinë e procesit.<sup>170</sup>

97. ZPS-ja përgjigjet se Pika 5 e z. Shala është e papranueshme, pasi në të përcaktohet në mënyrë të jo të plotë dhe të gabuar një aspekt faktik dhe përsëriten

---

<sup>164</sup> Kërkesa e Shalës, para. 39.

<sup>165</sup> Kërkesa e Shalës, para. 40.

<sup>166</sup> Kërkesa e Shalës, para. 40.

<sup>167</sup> Kërkesa e Shalës, para. 41-42.

<sup>168</sup> Kërkesa e Shalës, para. 41-42.

<sup>169</sup> Kërkesa e Shalës, para. 43-45.

<sup>170</sup> Kërkesa e Shalës, para. 46.

argumente të mëhershme të tij.<sup>171</sup> ZPS-ja argumenton se z. Shala nuk trajton konstatimet e Panelit të Apelit dhe se në argumentet e tij nuk faktohet asnjë shkelje e Ligjit apo shkelje thelbësore e procedurave.<sup>172</sup>

98. Mbrojtja e Viktimave përgjigjet se Pika 5 është e papranueshme pasi në të thjesht përsëriten pretendimet faktike ndaj besueshmërisë së dëshmitarëve, pretendime këto të cilat tashmë janë shqyrtuar në mënyrë të plotë dhe janë rrëzuar si nga Trupi Gjykses, ashtu dhe nga Paneli i Apelit, pa konstatuar asnjë shkelje të re të ligjit apo procedurave, siç kërkohet sipas nenit 48(7) të Ligjit.<sup>173</sup> Pretendimi kryesor i Mbrojtjes për “kompromentim të dukshëm” të dëshmive të familjarëve të W04733-shit, bazohet në keqinterpretimin e dëshmive, veçanërisht në lidhje me përmendjen e “Imer Imerit”, i cili në fakt u përmend prej vetë W04733-shit.<sup>174</sup>

99. Mbrojtja e Viktimave gjithashtu vëren se pretendimet në lidhje me ndërveprimin mes dëshmitarëve dhe ato për marrëveshje mes tyre (përfshirë praninë e TW4-08-ës në intervista dhe marrëdhënien midis TW4-01-shit dhe TW4-10-ës) u analizuan në mënyrë të qartë nga Trupi Gjykses dhe u rishikuan nga Paneli i Apelit, të cilët ose i hodhën poshtë këto argumente, ose nuk i dhanë peshë dëshmisë së kontestuar.<sup>175</sup> Rrjedhimisht, Mbrojtja demonstroi vetëm mospajtim me konstatimet faktike, por jo shkelje të procedurave apo ndikim thelbësor në rezultat.<sup>176</sup>

100. Z. Shala kundërpërgjigjet se Prokuroria dhe Mbrojtja e Viktimave i cilësojnë në mënyrë të pasaktë argumentet e tij si argumente që ngrenë pretendime faktike, kur në fakt ato kanë të bëjnë me drejtësinë e procesit.<sup>177</sup> Ai pretendon se mosushtrimi i kujdesit të duhur gjatë vlerësimit të dëshmive të dëshmitarëve të Prokurorisë, së

---

<sup>171</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 43.

<sup>172</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 43.

<sup>173</sup> Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 21.

<sup>174</sup> Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 22; Aktgjykimi i Apelit, para. 344.

<sup>175</sup> Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 22-23; Aktgjykimi, para. 371-375; Aktgjykimi i Apelit, para. 375.

<sup>176</sup> Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 24.

<sup>177</sup> Kundërpërgjigjja e Shalës, para. 10.

bashku me zbatimin e standardeve më të rrepta për provat e Mbrojtjes, shkeli të drejtën e z. Shala për gjykim të drejtë.<sup>178</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës Supreme

101. Paneli rikujton nenin 48(8) të Ligjit, ku thuhet se “kërkesa për mjete juridike të jashtëzakonshme sipas këtij neni mund të paraqitet në bazë të të drejtave në dispozicion sipas këtij Ligji të cilat janë të mbrojtura me Kushtetutë ose Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.<sup>179</sup> Rrjedhimisht, sipas nenit 48(7)(a) dhe (b) të Ligjit, pala që kërkon mbrojtjen e ligjshmërisë duhet të ngrejë pretendim për shkelje të të drejtës penale të përcaktuar në këtë Ligj dhe në Rregullore. Paneli vëren se z. Shala nuk i është referuar ndonjë neni në Ligj apo ndonjë rregulle në Rregullore, e lëre më ndonjë të drejtë të përfshirë në KEDNJ.<sup>180</sup> Z. Shala gjithashtu nuk ka specifikuar nëse kjo pikë bazohet në shkelje thelbësore të procedurave apo në shkelje të së drejtës penale.

102. Në vend të këtyre, z. Shala paraqet argumente që merren vetëm me provat.<sup>181</sup> Sidoqoftë, edhe këtu, z. Shala nuk trajton vlerësimin e këtij aspekti prej Panelit të Apelit.<sup>182</sup> Paneli rikujton se, përveç parimeve të përcaktuara më lart, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk parashtrohet për shkak të “përcaktimit të gabuar ose të paplotë të fakteve” ose për mospajtime me vlerësimin e fakteve prej gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë.

103. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Pika 5 është e papranueshme dhe e rrëzon menjëherë atë.

### F. MBËSHTETJE E PADREJTË NË PROVA TË PAVERIFIKUARA (PIKA 6)

---

<sup>178</sup> Kundërpërgjigja e Shalës, para. 10.

<sup>179</sup> Theksimi është shtuar.

<sup>180</sup> Shih Kërkesën e Shalës, para. 38-46.

<sup>181</sup> Kërkesa e Shalës, para. 38-46.

<sup>182</sup> Kërkesa e Shalës, para. 38-46.

## 1. Parashtrimet

104. Z. Shala parashtron se provat e paverifikuara nuk mund të përbëjnë bazën e vetme ose vendimtare të verdiktit të fajësisë.<sup>183</sup> Mbrojtja argumenton se Paneli i Apelit nuk kuptoi se në “provat e paverifikuara” përfshihen edhe dëshmitë gojore që jepen drejtpërdrejt në gjykim.<sup>184</sup> Mbi këtë bazë, konstatimi se z. Shala mori pjesë në NPK dhe transferoi W04733-shin në Kukës, është i paligjshëm, pasi mbështetet në prova të paverifikuara të dhëna nga anëtarë të familjes së W04733-shit pas vdekjes së tij.<sup>185</sup> Mbrojtja gjithashtu argumenton se mbështetja e Panelit në “praktikën e veprimit” të zbatuar gjerësisht të përdorjes së provave të paverifikuara për të mbështetur verdiktet e fajësisë për ndalim arbitrar, si dhe konstatimet që lidhen me një dëshmitar të caktuar dhe të afërmit e tij, shkelën të drejtën e z. Shala për t’u bërë pyetje dëshmitarëve kundër tij.<sup>186</sup> Rrjedhimisht, Mbrojtja pretendon se procesi ishte i padrejtë dhe se çështja gjyqësore duhet të kthehet për rigjykim.<sup>187</sup>

105. ZPS-ja përgjigjet se z. Shala pretendon dy shkelje të rregulës 140(4) të Rregullores, konkretisht konstatimin në lidhje me W04733-shin dhe konstatimin mbi mënyrën e veprimit, dhe se të dy konstatimet duhet të hidhen poshtë.<sup>188</sup> ZPS-ja argumenton se, sa i përket W04733-shit, konstatimi nuk ishte “thelbësor” (d.m.th. i domosdoshëm) për asnjë aspekt të verdiktit të fajësisë, gjë që ka rëndësi pasi rregulla 140(4) zbatohet vetëm për fakte të domosdoshme.<sup>189</sup> ZPS-ja gjithashtu deklaroi se argumenti i z. Shala është i mangët sepse shpërfill qasjen e saktë ligjore të Panelit të Apelit që dallon konstatimet “bazë” nga konstatimet “thelbësore”, dhe konstatimi në lidhje me W04733-shin ishte vetëm konstatim bazë midis shumë të tjerësh që

---

<sup>183</sup> Kërkesa e Shalës, para. 47.

<sup>184</sup> Kërkesa e Shalës, para. 47.

<sup>185</sup> Kërkesa e Shalës, para. 47.

<sup>186</sup> Kërkesa e Shalës, para. 48.

<sup>187</sup> Kërkesa e Shalës, para. 49.

<sup>188</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 44.

<sup>189</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 45.

mbështesin konstatimet thelbësore.<sup>190</sup> ZPS-ja arrin në përfundimin se mostrajtimi prej z. Shala i arsyetimit të Panelit të Apelit, do të thotë se ai nuk ka provuar se është bërë gabim në analizimin e rregullës 140(4), dhe Pika 6 duhet të rrëzohet në tërësi.<sup>191</sup>

106. Mbrojtja e Viktimave përgjigjet se Pika 6 është e papranueshme, pasi Mbrojtja përsëri kërkon të ridebatojë konstatime faktike tashmë të trajtuara në apel, pa u marrë me arsyetimin e Panelit të Apelit apo evidentuar ndonjë gabim procedural.<sup>192</sup> Sipas Mbrojtjes së Viktimave, pretendimi i Mbrojtjes se konstatimi në lidhje me pjesëmarrjen e z. Shala në transferimin e W04733-shit në Kukës u bazua vetëm në prova të paverifikuara, u shqyrtua dhe u hodh poshtë qartësisht nga Paneli i Apelit.<sup>193</sup>

107. Mbrojtja e Viktimave gjithashtu parashtrohet se argumenti i Mbrojtjes nuk është asgjë më shumë se një përsëritje e argumenteve të paraqitura më parë në apel, se ky argument është krejtësisht jashtë kuadrit të një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe se nuk përmbush standardin e pranueshmërisë.<sup>194</sup>

108. Z. Shala përgjigjet se prokuroria gabon që minimizon aspektin kyç në lidhje me dëshmitarin W04733, konkretisht se dëshmitë e dorës së dytë mbeten të paverifikuara edhe kur paraqiten përmes dëshmisë gojore, pasi nuk përbëjnë dëshmi të dorës së parë.<sup>195</sup> Mbrojtja argumenton se prova të tilla shkelin rregullën 140(4)(a) të Rregullores dhe se asnjë lloj marrjeje në pyetje nuk mund të korrigjojë pambështetshmërinë e vetvetishme të tyre apo të kompensojë pamundësinë e Mbrojtjes për të kundërshtuar në mënyrë të njëmendtë provat kundër z. Shala.<sup>196</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës Supreme

109. Paneli rikujton se, sipas nenit 48(7)(b) të Ligjit, pala që kërkon mbrojtjen e

---

<sup>190</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 47.

<sup>191</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 55.

<sup>192</sup> Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 25.

<sup>193</sup> Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 25; Aktgjykimi i Apelit, para. 493, 501.

<sup>194</sup> Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 25.

<sup>195</sup> Kundërpërgjigjja e Shalës, para. 11.

<sup>196</sup> Kundërpërgjigjja e Shalës, para. 11.

ligjshmërisë duhet të evidentojë shkeljen thelbësore të procedurave të përcaktuara në këtë Ligj dhe në Rregullore.<sup>197</sup> Paneli gjithashtu rikujton se pala që kërkon mbrojtjen e ligjshmërisë duhet të evidentojë dhe faktotë shkeljen e pretenduar të ligjit, dhe në rast të shkeljes së procedurave, të tregojë se si ka ndikuar thelbësisht në aktgjykimin e kundërshtuar.<sup>198</sup>

110. Z. Shala nuk evidenton asnjë shkelje thelbësore të një procedure konkrete të Ligjit ose Rregullores, por vetëm i referohet në mënyrë të përgjithshme rregullës 140(4) të Rregullores dhe poshtëshënimit 66 të Kërkesës.<sup>199</sup> Megjithatë, Paneli do të bëjë përjashtim dhe do të shqyrtojë themelësinë e kësaj pike, duke pasur parasysh rëndësinë që Paneli i jep të drejtës për liri, mbrojtjes së saj, integritetit të procesit dhe të drejtës për gjykim të drejtë.

111. Z. Shala argumenton se Paneli i Apelit nuk mori parasysh se dëshmia gojore në të cilën përsëriten prova të paverifikuara më parë, nuk e humb natyrën e saj të paverifikuar.<sup>200</sup> Megjithatë, Paneli i Apelit e trajtoi këtë aspekt kur rikujtoi se, sipas rregullës 140(4)(a) të Rregullores, shpallja e fajësisë nuk mund të bazohet “vetëm” në prova të paverifikuara.<sup>201</sup> Paneli i Apelit gjithashtu sqaroi se ky ndalim zbatohet për faktet që përbëjnë elemente të krimeve, për format e përgjegjësisë penale, dhe për çdo fakt që është i domosdoshëm për dhënien e një verdikti fajësie.<sup>202</sup> Paneli i Apelit konstatoi se ky ndalim përfshin edhe incidentet kriminale për të cilat janë ngritur akuza më vete, edhe kur një numër i këtyre incidenteve paraqiten në një pikë të vetme në aktakuzë.<sup>203</sup>

112. Gjithashtu, ndonëse provat që tregojnë një praktikë të njëjtë sjelljeje, në rrethana

---

<sup>197</sup> Shih nenin 48(7)(b) të Ligjit; Vendimin në lidhje me Veselin, para. 37.

<sup>198</sup> Vendimi në lidhje me Mustafën, para. 13, 22.

<sup>199</sup> Kërkesa e Shalës, para. 47-49.

<sup>200</sup> Kërkesa e Shalës, para. 47.

<sup>201</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 473-475.

<sup>202</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 478.

<sup>203</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 482-83.

të caktuara, mund të konfirmojnë provat e paverifikuara, Paneli i Apelit theksoi se vlerësimi për çdo konfirmim të tillë duhet të bëhet rast pas rasti; një provë e paverifikuar nuk mund të shërbejë thjesht për të konfirmuar një tjetër.<sup>204</sup> Gjithashtu, Paneli i Apelit e përqendroi analizën e vet në aspektin nëse konstatimet e kundërshtuara bazoheshin vetëm, ose në mënyrë vendimtare në prova të paverifikuara, pavarësisht elementëve më të gjerë të drejtësisë së përgjithshme të procesit apo faktorëve kompensues.<sup>205</sup>

113. Përveç referencave të përgjithshme nga Aktgjykimi dhe Aktgjykimi i Apelit, z. Shala nuk trajton konstatimet e Panelit të Apelit në këtë aspekt.<sup>206</sup> Po kështu, z. Shala nuk citon asnjë burim nga jurisprudenca në mbështetje të argumenteve të tij.

114. Bazuar në sa më lart, Paneli gjykon se z. Shala nuk provon se është kryer shkelje thelbësore e procedurave.

115. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Pika 6 është e papranueshme dhe e rrëzon atë.

G. GABIME NË LIDHJE ME VERDIKTIN E FAJËSISË PËR NDALIM ARBITRAR (PIKAT 7 DHE 3, PJESËRISHT)

### **1. Parashtrimet**

116. Mbrojtja argumenton se Trupi Gjykses dhe Paneli i Apelit e zbatuan gabim ligjin lidhur me veprën penale të ndalimit arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar.<sup>207</sup> Ato u mbështetën në standardet e nxjerra nga konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, por këto standarde nuk mund të zbatohen për konfliktin e armatosur jondërkombëtar.<sup>208</sup>

<sup>204</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 479-80.

<sup>205</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 486.

<sup>206</sup> Shih Kërkesën e Shalës, para. 47-49.

<sup>207</sup> Kërkesa e Shalës, para. 50-53.

<sup>208</sup> Kërkesa e Shalës, para. 54-55.

Mbrojtja argumenton se panelet gjithashtu i trajtuan orientimet procedurale si shqyrtimi i shpejtë gjyqësor dhe ekzistenca e një “autoritetit kompetent”, si elementë të veprimit të fajshëm, edhe pse këto garanci mbrojtëse zbatohen vetëm për shtetet.<sup>209</sup> Mbrojtja parashtron se UÇK-së i mungonte struktura shtetërore dhe gjyqësori i pavarur, çka pamundësonte përmbushjen e këtyre kriterëve.<sup>210</sup> Sipas Mbrojtjes, Paneli i Apelit gjithashtu gaboi që konstatoi se Mbrojtja “nuk kundërshtoi asnjëherë veprimin e fajshëm” të krimit të ndalimit arbitrar.<sup>211</sup>

117. Mbrojtja gjithashtu argumenton se panelet shkelën parimin e ligjshmërisë dhe nenin 7 të KEDNJ-së, pasi vepra penale e ndalimit arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar nuk ekzistonte në legjislacionin e Kosovës apo në të drejtën zakonore ndërkombëtare në vitin 1999.<sup>212</sup> Mbrojtja argumenton se Paneli i Apelit përmbysi detyrimin e vërtetimit duke kërkuar që z. Shala të tregonte se kjo vepër penale nuk ekzistonte, në vend që t'i kërkonte Prokurorisë të provonte pretendimin e vet.<sup>213</sup> Sipas Mbrojtjes, keqtrajtimi gjatë ndalimit nuk mund të shërbejë si element objektiv i ndalimit arbitrar, dhe legjislacioni në fuqi nuk e lidhte keqtrajtimin me të drejtën automatike për lirim.<sup>214</sup>

118. Mbrojtja gjithashtu kundërshton konstatimet e paneleve në lidhje me synimin kriminal. Sipas Mbrojtjes, panelet nxorrën përfundimin për synimin nga prania e rastësishme dhe pjesëmarrja e kufizuar, edhe pse z. Shala nuk kishte kompetencë për të arrestuar persona, për t'i mbajtur ata të ndaluar apo për t'i liruar të ndaluarit.<sup>215</sup> Provat e keqtrajtimit nuk provojnë synimin e nevojshëm për ndalim arbitrar.<sup>216</sup> Mbrojtja gjithashtu parashtron se panelet zbatuan një standard të fryrë dhe të

---

<sup>209</sup> Kërkesa e Shalës, para. 52, 57-59, 61-62.

<sup>210</sup> Kërkesa e Shalës, para. 55, 60-62.

<sup>211</sup> Kërkesa e Shalës, para. 53.

<sup>212</sup> Kërkesa e Shalës, para. 51, 54-55.

<sup>213</sup> Kërkesa e Shalës, para. 58, 62.

<sup>214</sup> Kërkesa e Shalës, para. 63-65.

<sup>215</sup> Kërkesa e Shalës, para. 65.

<sup>216</sup> Kërkesa e Shalës, para. 66.

pambështetur për ndalimin e bazuar në arsye sigurie.<sup>217</sup>

119. ZPS-ja përgjigjet se Pika 7 nuk qëndron sepse z. Shala paraqet pesë argumente në lidhje me ndalimin arbitrar, konkretisht statusin e kësaj vepre penale në të drejtën zakonore në konfliktet e armatosura jondërkombëtare, kriteret e veprimit të fajshëm, mospasjen e pretenduar të qasjes prej UÇK-së në një autoritet kompetent në vitin 1999, rolin e keqtrajtimit dhe përgjegjësinë penale të tij sipas formës së NKP-së, megjithatë, asnjë prej këtyre argumenteve nuk shpërfaq asnjë gabim ligjor ose procedural.<sup>218</sup> ZPS-ja së pari argumenton se kundërshtimet e z. Shala në lidhje me bazën në të drejtën zakonore të ndalimit arbitrar dhe artikulumin e veprimit të fajshëm në të, janë thjesht riformulim i argumenteve në lidhje me ligjshmërinë të parashtruara në Pikën 3, çka i bën ato të tepërta.<sup>219</sup> Sipas ZPS-së, pretendimi i z. Shala se Paneli i Apelit përmbysi detyrimin e vërtetimit, është shtrembërim: Paneli i Apelit thjesht rrëzoi kundërshtimin e pafaktuar të z. Shala ndaj analizës nga pikëpamja e të drejtës zakonore, pasi nuk konstatoi asnjë ndryshim strukturor midis të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në përcaktimin e krimit të ndalimit arbitrar.<sup>220</sup>

120. Lidhur me argumentet e mbetura të z. Shala, ZPS-ja parashton se kërkesa për rishikim nga një autoritet i pavarur është tipar i vetvetishëm i moslejimit të ndalimit arbitrar dhe vlen për të gjithë aktorët në një konflikt të armatosur jondërkombëtar, prandaj mungesa e pretenduar e kapacitetit institucional prej UÇK-së është ligjërisht jorelevante dhe nuk bën përmbysje të detyrimit të vërtetimit.<sup>221</sup> ZPS-ja gjithashtu argumenton se pretendimi i z. Shala në lidhje me keqtrajtimin, është i pabazë, pasi në Aktgjykim keqtrajtimi nuk trajtohet si element objektiv i krimit, se argumentet e tij në lidhje me NKP-në bazohen në keqinterpretimin e çështjes *Delaliq* pasi në to

---

<sup>217</sup> Kërkesa e Shalës, para. 67.

<sup>218</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 56.

<sup>219</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 56-57.

<sup>220</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 58-60.

<sup>221</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 61-63.

ngatërrohet kryerja e drejtpërdrejtë me përgjegjësinë për NKP-në, dhe se Paneli i Apelit me të drejtë i hodhi poshtë këto argumente.<sup>222</sup> Së fundi, ZPS-ja deklaroi se një aspekt i veprimit të fajshëm i kundërshtuar prej z. Shala u rrëzua në apel, çka e bën abstrakte dhe pa ndikim thelbësor çdo ankesë të mbetur, dhe, rrjedhimisht, Pika 7 duhet të rrëzohet në tërësi.<sup>223</sup>

121. Mbrojtja përgjigjet se, në kundërshtim me çka argumenton Prokuroria, Trupi Gjykesues e trajtoi keqtrajtimin shprehimisht dhe në mënyrë të gabuar si element objektiv të krimit të ndalimit arbitrar.<sup>224</sup> Mbrojtja argumenton se konstatimi i Trupit Gjykesues se keqtrajtimi i të ndaluarve ishte "thelbësor" për përmbushjen e elementeve materiale të veprës penale tregon se Trupi Gjykesues u mbështet në mënyrë të papërshtatshme të keqtrajtimit për përcaktimin e elementeve objektive të ndalimit arbitrar.<sup>225</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës Supreme

122. Paneli fillimisht rikujton se, krahas argumenteve të paraqitura në Pikën 7, Paneli në kuadër të kësaj pike do të shqyrtojë edhe argumentet e paraqitura prej z. Shala në Pikën 3, për sa lidhen me ndalimin arbitrar. Paneli fillimisht do të trajtojë argumentet e z. Shala në lidhje me pretendimin për shkelje të parimit të ligjshmërisë për ndalimin arbitrar të parashtruara në Pikën 3.

123. Në këtë aspekt, Paneli vëren se z. Shala argumenton se është shkelur kriteri i disponueshmërisë dhe parashikueshmërisë, si dhe parimi i ligjshmërisë i garantuar nga neni 7(1) i KEDNJ-së, neni 33 i Kushtetutës së Kosovës dhe neni 15 i MNDCP-së.<sup>226</sup> Z. Shala gjithashtu përmend shkeljen e kryer prej Trupit Gjykesues dhe Panelit të Apelit në lidhje me zbatimin e nenit 14(1)(c) të Ligjit dhe pretendon se Trupi Gjykesues

<sup>222</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 66-69.

<sup>223</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 72-73.

<sup>224</sup> Kundërpërgjigjja e Shalës, para. 12.

<sup>225</sup> Kundërpërgjigjja e Shalës, para. 13.

<sup>226</sup> Kërkesa e Shalës, para. 27, 29. Shih gjithashtu Kërkesën e Shalës, para. 51.

dhe Paneli i Apelit kryen “shkelje thelbësore të ligjit në kuptim nenit 48(7)-(8) të Ligjit dhe rregullës 193 të Rregullores”.<sup>227</sup>

124. Paneli i kupton argumentet e z. Shala që i referohen nenit 7 të KEDNJ-së si të bazuara në shkeljen e pretenduar të të drejtës penale dhe, duke marrë parasysh sa më lart, konstaton se ky aspekt i Pikës 3 është i pranueshëm. Rrjedhimisht, Paneli do t'i shqyrtojë argumentet e z. Shala në bazë të themelësisë së tyre.

125. Paneli rikujton se Paneli i Apelit e ka trajtuar në një sërë rastesh aspektin nëse ndalimi arbitrar ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën e krimeve të pretenduara, përfshirë këtu rastin e z. Shala, dhe ka bërë një analizë të gjatë për këtë.<sup>228</sup> Në lidhje me apelin e z. Shala kundër Aktgjykimit, Paneli i Apelit konfirmoi konstatimin e mëhershëm të tij se:

- (i) juridiksioni i Dhomave të Specializuara nuk kufizohet në veprat penale të përmendura shprehimisht në 14(1)(c) të Ligjit; (ii) formulimi joshterues i dispozitës nuk shkel parimin e sigurisë juridike (*lex certa*) duke pasur parasysh se, që një veprim të përfshihet në Ligj dhe rrjedhimisht të jetë nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara, ai duhet të ketë ekzistuar sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara dhe duhet të përbëjë shkelje të rëndë të Nenit të Përbashkët 3; (iii) ndalimi arbitrar përbën shkelje të rëndë të Nenit të Përbashkët 3 kur shkelet parimi i trajtimit njerëzor, pavarësisht nëse ekziston bazë ligjore për ndalimin e personit; (iv) ndalimi arbitrar gjatë një konflikti të armatosur jondërkombëtar ishte vepër penale sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare në periudhën që mbulojnë akuzat; (v) në kohën përkatëse, për të akuzuarin ishte e disponueshme dhe e parashikueshme që pjesëmarrja në veprime të ndalimit arbitrar mund të rezultonte në përgjegjësi penale individuale; dhe (vi) akuzat për ndalim arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar në këtë çështje gjyqësore nuk shkelin parimin e ligjshmërisë.<sup>229</sup>

126. Paneli gjithashtu dëshiron të theksojë se, siç është konstatuar më parë prej Panelit të Apelit, “një interpretim i thjeshtë i nenit 142 të Kodit Penal të RFSJ-së dhe i dispozitave përkatëse të legjislacionit penal të vendeve të tjera të ish-Jugosllavisë,

<sup>227</sup> Kërkesa e Shalës, para. 30.

<sup>228</sup> Shih Vendimin mbi Apelin e Shalës lidhur me Juridiksionin, para. 44-47. Shih gjithashtu Vendimin e Apelit në lidhje me Juridiksionin në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët; Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës*, KSC-CA-2023-02/F00038/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit të Apelit, 14 dhjetor 2023 (“Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Mustafa*”), para. 430.

<sup>229</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 176. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit, para. 618.

tregon se në këto dispozita përmendej shprehimisht vepra penale e arrestimit [dhe ndalimit] të paligjshëm si krim lufte, pa bërë dallim midis konfliktit të armatosur jondërkombëtar dhe atij ndërkombëtar”.<sup>230</sup>

127. Paneli i Apelit, ndërsa vuri në dukje se z. Shala thjesht përsëriste argumentet e paraqitura në rastet e mëparshme para Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe Panelit të Apelit,<sup>231</sup> trajtoi edhe argumentet shitesë të ngritura prej z. Shala “për të qenë i drejtë me të akuzuarin dhe në interes të drejtësisë”.<sup>232</sup> Konkretisht, Paneli i Apelit konstatoi se:

argumentet e Shalës se UÇK-ja nuk ishte e organizuar në masë të mjaftueshme për zbatimin e të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe për këtë arsye anëtarët e UÇK-së nuk mund të parashikonin se mund të ishin penalisht përgjegjës për ndalim arbitrar, bien ndesh me faktet e shqyrtuara në procese të tjera, provat e administruara, përfshirë deklaratat e mëparshme të Shalës, dhe konstatimet e Trupit Gjykues.<sup>233</sup>

128. Paneli vëren se z. Shala edhe këtu, në një paragraf, përsërit argumentet e ngritura më parë.<sup>234</sup> Z. Shala nuk trajton në mënyrë thelbësore vendimet dhe aktgjykimet e ndryshme të Panelit të Apelit, ku shtjellohet gjerësisht aspekti i moslejimit të ndalimit arbitrar sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare gjatë kohës kur u kryen krimet. Paneli ka shqyrtuar me kujdes konstatimet e bëra në vendime dhe aktgjykime të ndryshme në lidhje me këtë aspekt dhe pajtohet me to.<sup>235</sup> Rrjedhimisht, Paneli është bindur se as Trupi Gjykues dhe as Paneli i Apelit nuk kanë shkelur të drejtën penale me konstatimin se para vitit 1998, ndalimi arbitrar apo i paligjshëm tashmë dënohej gjerësisht dhe njihej sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare si shkelje e rëndë e të drejtës humanitare ndërkombëtare, kjo edhe në konflikte të armatosura jondërkombëtare, dhe se një shkelje e tillë mund të shkaktonte pasoja në

<sup>230</sup> Vendimi i Apelit në lidhje me Juridiksionin në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 107.

<sup>231</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 171, 174, 177.

<sup>232</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 177 (citimet e brendshme janë hequr).

<sup>233</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 178 (citimet e brendshme janë hequr).

<sup>234</sup> Shih Kërkesën e Shalës, para. 29. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit, para. 166.

<sup>235</sup> Shih Aktgjykimin e Apelit, paras 176-181, 618; Vendimin mbi Apelin e Shalës lidhur me Juridiksionin, para. 44-47; Vendimin e Apelit në lidhje me Juridiksionin në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 87-102, 106-109; Aktgjykimin e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 430-431.

aspektin e përgjegjësive penale.<sup>236</sup> Me fjalë të tjera, Paneli konstaton se z. Shala nuk provon se është shkelur e drejta penale.

129. Bazuar në sa më lart, Paneli rrëzon Pikën 3 sa i përket argumenteve të z. Shala në lidhje me ndalimin arbitrar.

130. Paneli tani do të trajtojë argumentet e z. Shala në lidhje me ndalimin arbitrar sipas Pikës 7.

131. Paneli vëren se z. Shala nuk ka evidentuar asnjë nen në Ligj dhe asnjë rregullë ne Rregullore apo nen të KEDNJ-së që lidhet me to, por vetëm u është referuar në mënyrë të përgjithshme kritereve të pranueshmërisë për kërkesat referuese sipas nenit 48(7)-(8) të Ligjit dhe rregullës 193 të Rregullores, duke sugjeruar se ato janë shkelur.<sup>237</sup> Z. Shala nuk saktëson nëse ndonjë prej këtyre gabimeve të pretenduara përbën shkelje thelbësore të procedurave apo shkelje të të drejtës penale.<sup>238</sup>

132. Paneli rikujton se “palët pritet të jenë të sakta në argumentet e tyre para Dhomave të Specializuara”.<sup>239</sup> Paneli gjithashtu rikujton se mund ta rrëzojë një pikë si të papranueshme, kur në të nuk ka asnjë referencë për shkelje të Rregullores apo të neneve të Ligjit.<sup>240</sup>

133. Megjithatë, edhe me këto mangësi të Kërkesës të përmendura më lart, Paneli do të bëjë përjashtim dhe do të shqyrtojë themelësinë e kësaj pike, ashtu si e percepton Paneli, në lidhje me pretendimin për shkelje të të drejtës penale, duke pasur parasysh rëndësinë që Paneli i jep të drejtës për liri, mbrojtjes së saj, integritetit të procesit dhe të drejtës për gjykim të drejtë.

134. Z. Shala në thelb argumenton se Trupi Gjykses dhe Paneli i Apelit gabuan që

---

<sup>236</sup> Shih Vendimin e Apelit në lidhje me Juridiksionin në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 108.

<sup>237</sup> Shih Kërkesën e Shalës, para. 50-69.

<sup>238</sup> Kërkesa e Shalës, para. 50-69.

<sup>239</sup> Vendimi mbi Kërkesën e H. Shalës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 33.

<sup>240</sup> Vendimi mbi Kërkesën e H. Shalës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 33.

arritën në përfundimin se elementet objektive të veprimit të fajshëm të ndalimit arbitrar gjatë një konflikti të armatosur, si dhe garancitë mbrojtëse që zbatohen për të, mund të zbatohen *mutatis mutandis* për të njëjtin krim brenda një konflikti të armatosur jondërkombëtar.<sup>241</sup> Më fjalë të tjera, z. Shala argumenton se ndalimi arbitrar në një konflikt të armatosur ndërkombëtar u vë detyrime shteteve, të cilat nuk mund t'u transferohen aktorëve joshtetërorë gjatë një konflikti të armatosur jondërkombëtar.

135. Sipas Panelit, argumentet e z. Shala bazohen në shkeljet e pretenduara të bëra në lidhje me interpretimin e një vepre penale sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit.

136. Shkeljet e pretenduara që ka evidentuar z. Shala i ka përmbledhur si më poshtë:

(i) trajtimi i mungesës së garancive mbrojtëse procedurale, konkretisht, nxjerrjes pa vonesë para një gjykatësi apo autoriteti tjetër kompetent dhe dhënies së mundësisë për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit, si elemente të veprimit të fajshëm të veprës penale; (ii) zbatimi i një standardi padrejtësisht të rreptë në lidhje me çfarë përbën "autoritet kompetent"; (iii) konstatimi se ishte jorelevante nëse kryesi ishte personalisht përgjegjës për mosrespektimin e garancive mbrojtëse procedurale; dhe (iv) vendosja si kriter që në mënyrë që ndalimi për arsye sigurie të jetë i ligjshëm, ai duhet të jetë "absolutisht" i domosdoshëm.<sup>242</sup>

137. Në lidhje me shkeljen e parë të evidentuar, Paneli vëren se Paneli i Apelit i shqyrtoi gjerësisht argumentet e z. Shala në lidhje me mënyrën se si Trupi Gjykses përcaktoi konturet e garancive procedurale bazë për nxjerrjen e një personi të ndaluar para një gjykatësi apo autoriteti tjetër kompetent dhe për t'i mundësuar personit të ndaluar të kundërshtojë ligjshmërinë e ndalimit.<sup>243</sup> Trupi Gjykses e përcaktoi veprimin e fajshëm të krimit të luftës të ndalimit arbitrar si më poshtë:

krimi i luftës i ndalimit arbitrar, sipas kuptimit të nenit 14(1)(c) të Ligjit, kryhet nëpërmjet një veprimi apo mosveprimi që sjell si pasojë heqjen e lirisë së një personi që nuk merr pjesë aktive në luftime, pa bazë ligjore dhe pa përmbushur garancitë procedurale bazë.<sup>244</sup>

138. Më tej, në lidhje me garancitë procedurale bazë, Trupi Gjykses sqaroi se në detyrimet e autoriteteve që kryejnë ndalimin ndaj personit të ndaluar përfshihen: (i)

---

<sup>241</sup> Kërkesa e Shalës, para. 54.

<sup>242</sup> Kërkesa e Shalës, para. 52 (citimet e brendshme janë hequr).

<sup>243</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 623-630.

<sup>244</sup> Aktgjykimi, para. 936.

detyrimi për të informuar personin për arsyet pse i është hequr liria; (ii) detyrimi për të nxjerrë pa vonesë personin të cilit i është hequr liria para një gjykatësi apo një autoriteti tjetër kompetent; dhe (iii) detyrimi për t'i dhënë atij mundësinë për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tij.<sup>245</sup>

139. Paneli vëren se Paneli i Apelit trajtoi pretendimin e z. Shala se burimet ligjore në të cilat u mbështet Trupi Gjykses në lidhje me ndalimin arbitrar në një konflikt të armatosur ndërkombëtar, nuk mund të përdoren për të interpretuar garancitë procedurale për të njëjtin krim në një konflikt të armatosur jondërkombëtar, ku të përfshirë janë aktorë joshtetërorë.<sup>246</sup>

140. Paneli gjithashtu vëren se Paneli i Apelit rikujtoi me të drejtë se parimi i ligjshmërisë nuk e pengon një gjykatë të interpretojë dhe sqarojë elementet e një veprë penale.<sup>247</sup> Në këtë kontekst, Paneli i Apelit gjithashtu paralajmëroi se “e drejta dhe praktika ndërkombëtare për të drejtat e njeriut mund të jenë relevante për disa, por jo për të gjitha aspektet e një ndalimi sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare zakonore, shkelja e të cilit krijon përgjegjësi penale individuale”.<sup>248</sup> Megjithatë, Paneli i Apelit konstatoi se:

Në këtë rast, interesat e të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe ato të së drejtës humanitare ndërkombëtare (p.sh. qëllimet e përbashkëta dhe interesat e mbrojtura) gjerësisht përputhen në aspektin që, siç shpjegon KNKK-ja, ato synojnë “parandalimin e ndalimit arbitrar përmes specifikimit të arsyeve të mbajtjes në ndalim bazuar në nevoja, në veçanti nevojat e sigurisë, dhe përmes përcaktimit të kushteve dhe procedurave për parandalimin e zhdukjes së personave dhe mbikëqyrjen e nevojës për vazhdimin e mbajtjes në ndalim”.<sup>249</sup>

141. Pasi shqyrtoi me kujdes konstatimet e Panelit të Apelit në lidhje me këtë aspekt, Paneli pajtohet me to. Paneli mban parasysh se UÇK-ja nuk kishte struktura të brendshme të rrënjosura të njëjta me ato të një shteti. Megjithatë, Paneli është i

---

<sup>245</sup> Aktgjykimi, para. 938.

<sup>246</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 623-630.

<sup>247</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 624. Shih gjithashtu Vendimin në lidhje me Gucatin dhe Haradinajn, para. 44.

<sup>248</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 624.

<sup>249</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 624.

mendimit se natyra dhe struktura e një aktori joshtetëror nuk e përjashton atë si të tillë nga detyrimi për të siguruar që ndalimi i personave të mos jetë arbitrar. Në këtë aspekt Paneli mban parasysh studimin e KNKK-së në të cilin mbështetet z. Shala,<sup>250</sup> ku ndër të tjera përcaktohet se në lidhje me garancitë procedurale në kontekstin e aktorëve joshtetërorë dhe shtetërorë në një konflikt të armatosur jondërkombëtar, “shqyrtimi i ligjshmërisë së ndalimit duhet të bëhet nga një organ i pavarur dhe i paanshëm”.<sup>251</sup>

142. Bazuar në sa më lart, Paneli nuk evidenton asnjë shkelje të të drejtës penale në lidhje me burimet ligjore në të cilat mbështetet Trupi Gjykses, të analizuar gjerësisht dhe të konfirmuara më pas nga Paneli i Apelit, për përcaktimin e garancive procedurale të zbatueshme për krimin e luftës të ndalimit arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar. Paneli gjithashtu gjykon se z. Shala nuk ka provuar se garancitë procedurale të përcaktuara prej Trupit Gjykses dhe të miratuara prej Panelit të Apelit, nuk u përcaktuan me qartësi të mjaftueshme apo ishin paparashikueshme për të në kohën kur u kryen krimet.

143. Duke pasur parasysh natyrën mbrojtëse të moslejimit të ndalimit arbitrar, Paneli është i mendimit se mungesa e deklaruar prej z. Shala e një autoriteti të pavarur brenda UÇK-së, në vetvete, nuk do të thotë se ajo nuk duhej t’i përmbushte detyrimet e saj dhe të përcaktonte autoritetin kompetent kur ndalonte individë gjatë konfliktit.<sup>252</sup> Paneli vëren se z. Shala nuk i referohet ndonjë jurisprudence apo burimi tjetër ligjor në këtë aspekt për të mbështetur argumentin e tij se autoriteti kompetent “mund të ekzistojë vetëm kur pala në konflikt zotëron të paktën disa tipare të pushtetit qeverisës”.<sup>253</sup> Në fakt, Paneli gjykon se nga aktorët joshtetërorë kërkohet që t’i trajtojnë

---

<sup>250</sup> Shih Kërkesën e Shalës, para. 54.

<sup>251</sup> ICRC, Commentary on the Third Geneva Convention: Convention (III) relative to the Treatment of Prisoners of War, 2nd edition, 2020, para. 761.

<sup>252</sup> ICRC, Internment by Non-State Armed Groups: Legal and Practical Limits, Tilman Rodenhäuser, 14 October 2024 (“Kur një person ndalohet, për të parandaluar arbitraritetin ka nevojë për një procedurë shqyrtimi. Ajo duhet të përfshijë informimin e personit për arsyet e ndalimit, dhënien e mundësisë atij për t’i kundërshtuar këto arsye, shqyrtimin e këtyre kundërshtimeve dhe rishikimin rregullisht në një mënyrë të pavarur dhe të paanshme të nevojës për ndalim”).

<sup>253</sup> Kërkesa e Shalës, para. 59.

individët që ndalojnë me dinjitet dhe në përputhje me të drejtën humanitare ndërkombëtare. Ata po kështu mund të mbahen përgjegjës kur shkelin detyrimet e tyre në këtë drejtim, veçanërisht kur shkelja përbën krim lufte.

144. Së fundi, Paneli hedh poshtë argumentin e z. Shala se Paneli i Apelit përmbysi detyrimin e vërtetimit kur i kërkoi atij të provonte se ndalimi arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën kur u kryen krimet, si dhe elementet e veprimit të fajshëm të kësaj vepre penale.<sup>254</sup> Z. Shala u shpall fajtor për këtë veprë penale prej Trupit Gjykses dhe, në përputhje me standardin e zbatueshëm të shqyrtimit në fazën e apelit, duhet të provojë se Trupi Gjykses bëri gabim rreth një çështjeje juridike që e shfuqizon aktgjykimin.<sup>255</sup>

145. Rrjedhimisht, Paneli gjykon se z. Shala nuk provoi se Trupi Gjykses dhe Paneli i Apelit shkelën të drejtën penale me konstatimin se një prej garancive procedurale në lidhje me veprimin e fajshëm të ndalimit arbitrar përfshin rishikimin e ndalimit nga një autoritet i pavarur kompetent.

146. Paneli në vijim do të trajtojë shkeljen e dytë të pretenduar prej z. Shala, konkretisht “zbatimin e një standardi padrejtësisht të rreptë në lidhje me çfarë përbën ‘autoritet kompetent’”.<sup>256</sup> Paneli vëren se z. Shala nuk e shtjellon më tej këtë argument dhe as shpjegon se si Trupi Gjykses apo Paneli i Apelit shkelën të drejtën penale në këtë aspekt.<sup>257</sup> Në vend të kësaj, z. Shala paraqet argumente që duket se lënë të kuptohet se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se UÇK-ja mund të kishte siguruar praninë e një “autoriteti kompetent”, duke pasur parasysh faktin se ajo “asnjëherë nuk pati kapacitetet apo karakteristikat e një ushtrie të rregullt”.<sup>258</sup> Paneli vëren se Paneli i

---

<sup>254</sup> Shih Kërkesën e Shalës, para. 58.

<sup>255</sup> Neni 46 i Ligjit. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit, para. 27.

<sup>256</sup> Kërkesa e Shalës, para. 52.

<sup>257</sup> Shih Kërkesën e Shalës, para. 53-69. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Shalës, para. 12-13.

<sup>258</sup> Kërkesa e Shalës, para. 60. Shih gjithashtu Kërkesën e Shalës, para. 61-63, 68.

Apelit hyri në një analizë të gjatë të konstatimeve të Trupit Gjykses, si bazë për vendimin e tij në lidhje me këtë aspekt.<sup>259</sup>

147. Paneli rikujton se pala që kërkon mbrojtje të ligjshmërisë duhet jo vetëm të evidentojë shkeljen e pretenduar, por edhe ta faktojë atë. Paneli gjithashtu rikujton se argumentet me të cilët pretendohet për përcaktim të gabuar ose të paplotë të fakteve, nuk janë në kompetencën e këtij Paneli.

148. Bazuar në sa më lart, Paneli rrëzon argumentin e dytë të z. Shala sipas Pikës 7.

149. Paneli tani do të trajtojë argumentin e tretë të z. Shala sipas kësaj Pikës 7, konkretisht shkeljen e pretenduar që Trupi Gjykses bëri me konstatimin se “ishte jorelevante nëse kryesi ishte personalisht përgjegjës për mosrespektimin e garancive mbrojtëse procedurale”,<sup>260</sup> konstatim ky i konfirmuar edhe prej Panelit të Apelit. Sipas z. Shala, Trupi Gjykses e zgjeroi në mënyrë të palejueshme përgjegjësinë për NKP-në për t’iu afruar formës së “fajësisë për shkak të anëtarësisë”.<sup>261</sup> Në lidhje me këtë, z. Shala mbështetet në konstatimin e Dhomës së Apelit të TPNJ-së në çështjen *Delaliqui dhe të tjerët*, konkretisht se “për të vërtetuar se një individ ka kryer veprën penale [...], duhet të provohet diçka më shumë sesa thjesht ‘pjesëmarrja’ e vetëdijshe në një sistem ose operacion të përgjithshëm, në kuadër të të cilit mbahen të ndaluar civilë”.<sup>262</sup>

150. Paneli vëren se Paneli i Apelit hodhi poshtë mbështetjen e z. Shala në Aktgjykimin e Apelit në çështjen *Delaliqui dhe të tjerët* të TPNJ-së, dhe konstatoi se “nga leximi në tërësi i mendimit të shprehur prej Dhomës së Apelit të TPNJ-së në lidhje me këtë aspekt, është e qartë se Dhoma analizoi format e ndryshme të kryerjes së veprës penale dhe shkallët përkatëse të afërsisë me veprën penale. Kur iu referua kryerjes’ dhe ‘përgjegjësisë penale parësore’, Dhoma e Apelit e TPNJ-së e kishte fjalën për

<sup>259</sup> Shih Aktgjykimin e Apelit, para. 643-664.

<sup>260</sup> Kërkesa e Shalës, para. 52. Shih gjithashtu Kërkesën e Shalës, para. 65-66.

<sup>261</sup> Kërkesa e Shalës, para. 65.

<sup>262</sup> Kërkesa e Shalës, para. 65, ku citohet Aktgjykimi i Apelit në Çështjen e TPNJ-së, *Delaliqui dhe të tjerët*, IT-96-21-A, 20 shkurt 2001 (“Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Delaliqui dhe të tjerët*”), para. 342.

kryerjen e drejtpërdrejtë. Ajo bëri dallimin mes kësaj forme më të drejtpërdrejtë ose më të afërt të kryerjes dhe formave më pak të drejtpërdrejta të kryerjes së veprës penale, siç është NKP-ja”.<sup>263</sup> Paneli pajtohet me mendimin e Panelit të Apelit se mbështetja e z. Shala në konstatimin e Dhomës së Apelit të TPNJ-së në çështjen gjyqësore *Delaliqi dhe të tjerët* për të argumentuar se kur bëhet fjalë për synimin kriminal për ndalim arbitrar, “duhet të provohet diçka më shumë sesa thjesht ‘pjesëmarrja’ në një sistem të përgjithshëm”<sup>264</sup>, është e pavend, pasi ajo çështje në fakt ka të bëjë me kryerjen e drejtpërdrejtë.

151. Sikurse theksoi Paneli i Apelit, z. Shala nuk u shpall fajtor si kryes i drejtpërdrejtë i ndalimit arbitrar si krim lufte; ai u shpall fajtor në bazë të NKP I-shit.<sup>265</sup> Paneli vëren se Paneli i Apelit gjithashtu theksoi me të drejtë se për synimin kriminal që çon të përgjegjësia penale sipas NKP I-shit, kërkohet më shumë sesa “thjesht pjesëmarrja e vetëdijshme”.<sup>266</sup> Paneli gjithashtu rikujton se aspekti se a u paraqitën apo jo në gjyq prova të mjaftueshme në lidhje me synimin kriminal të z. Shala për kryerjen e krimit të luftës të ndalimit arbitrar, është vlerësim faktik dhe jashtë kompetencës së këtij panelit.

152. Bazuar në sa më lart, Paneli rrjedhimisht konstaton se z. Shala nuk provoi se Trupi Gjykses ose Paneli i Apelit gabuan me standardin që zbatuan për synimin kriminal për kryerjen e krimit të luftës të ndalimit arbitrar dhe me shpalljen e tij fajtor sipas NKP I-shit për këtë krim. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon këtë aspekt të Pikës 7.

153. Në vijim Paneli trajton argumentin e fundit të z. Shala, konkretisht se Trupi Gjykses dhe Paneli i Apelit gabuan që “vendosën si kriter që në mënyrë që ndalimi për arsye sigurie të jetë i ligjshëm, ai duhet të jetë “absolutisht” i domosdoshëm”.<sup>267</sup> Z.

---

<sup>263</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 740. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit në Çështjen *Delaliqi dhe të tjerët*, para. 343, 345.

<sup>264</sup> Shih Kërkesën e Shalës, para. 65.

<sup>265</sup> Shih Aktgjykimin e Apelit, para. 740.

<sup>266</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 740. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit, para. 741.

<sup>267</sup> Kërkesa e Shalës, para. 52. Shih gjithashtu Kërkesën e Shalës, para. 67.

Shala parashtron se standardi “absolutisht i domosdoshëm”, “nuk ka asnjë lidhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare” dhe se GJEDNJ-ja “për shembull, zbaton standardin ‘rreptësisht’ i domosdoshëm ose i kërkuar nga nevojat e një situatë të caktuar”.<sup>268</sup>

154. Paneli vëren se z. Shala duket se mospajtimin e vet me zbatimin e standardit “absolutisht i domosdoshëm”, po e shpreh për herë të parë para këtij Paneli. Z. Shala paraqiti një sërë argumentesh në lidhje me këtë kur trajtoi aspekte të Aktgjykimit, por nuk kundërshtoi para Panelit të Apelit vetë përdorimin e togfjalëshit “absolutisht i domosdoshëm”.<sup>269</sup> Në vend të kësaj, para Panelit të Apelit z. Shala sugjeroi se standardi i duhur duhej të kishte qenë “nëse ekzistonte dyshim në lidhje me secilin të ndaluar, që mund të konsiderohej i arsyeshëm në atë kohë”.<sup>270</sup>

155. Paneli rikujton se nuk do të shqyrtojë *de novo* në nivel të Gjykatës Supreme argumente që mund të ishin paraqitur në mënyrë të arsyeshme para paneleve në shkallë të parë dhe të dytë. Gjithashtu, Z. Shala nuk tregon se ku ndryshon standardi “rreptësisht i domosdoshëm” nga ai “absolutisht i domosdoshëm” dhe çfarë ndikimi, nëse ka, do të kishte ky ndryshim i pretenduar në konstatimet e Trupit Gjykses dhe Panelit të Apelit. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon këtë aspekt të Pikës 7.

156. Së fundi, Paneli vëren se z. Shala ngre një argument tjetër të papërfshirë në shkeljet e pretenduara të renditura në paragrafin 52 të Kërkesës së Shalës. Konkretisht, z. Shala pretendon se keqtrajtimi i të ndaluarve gjatë marrjes në pyetje nuk mund të “trajtohet si element objektiv i krimit të ndalimit arbitrar”.<sup>271</sup>

157. Paneli vëren se z. Shala nuk citon asnjë konstatim të Trupit Gjykses apo të Panelit të Apelit në lidhje me këtë argument.<sup>272</sup> Në fakt, z. Shala nuk citon asgjë për

---

<sup>268</sup> Kërkesa e Shalës, para. 67.

<sup>269</sup> Shih Kërkesën e Shalës, para. 131, 214, 216-218.

<sup>270</sup> Shih Aktgjykimin e Apelit, para. 721.

<sup>271</sup> Kërkesa e Shalës, para. 64.

<sup>272</sup> Shih Kërkesën e Shalës, para. 64.

këtë argument, as Aktgjykimin, as Aktgjykimin e Apelit dhe as ndonjë burim tjetër ligjor apo jurisprudencë. Paneli nuk mund të trajtojë argumentin e z. Shala në lidhje me keqtrajtimin si element objektiv i krimit të ndalimit arbitrar kur ai nuk faktohet, nuk shpjegohet ose kur nuk jepen citime. Sidoqoftë, Paneli vëren se as Trupi Gjykses dhe as Paneli i Apelit nuk kanë konstatuar se keqtrajtimi i një të ndaluarit përbën element objektiv të ndalimit arbitrar si krim lufte.<sup>273</sup>

158. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon argumentin e z. Shala në këtë aspekt.

159. Bazuar në sa më lart, Paneli, rrjedhimisht, rrëzon Pikën 7 në tërësi.

H. VERDIKTI I FAJËSISË PËR VRASJE TË PALIGJSHME ËSHTË I GABUAR (PIKA 8)

### 1. Parashtrimet

160. Z. Shala parashtron se Paneli zgjeroi në mënyrë të palejueshme përmes NKP-së përgjegjësinë penale të tij për vdekjen e viktimës, edhe pse ai nuk luajti rol integral në vrasje.<sup>274</sup> Mbrojtja argumenton se Trupi Gjykses u mbështet në tre elementë të gabuar për të konstatuar se plani i përbashkët parashikonte vrasjen e paligjshme. Së pari, Trupi Gjykses e lidhi vrasjen me keqtrajtimin e të ndaluarve, edhe pse z. Shala nuk ishte i pranishëm gjatë gjuajtjes me armë zjarri, që do të thotë se ky akt nuk ishte pjesë e planit të përbashkët.<sup>275</sup> Së dyti, Paneli u mbështet në prova të paverifikuara dhe të pakonfirmuara se z. Shala kishte kërcënuar në një rast një të ndaluar, pasi, edhe po të pranohej, kjo më së shumti do të mund të tregonte synimin ndaj një individi konkret, jo ndaj vetë viktimës.<sup>276</sup>

161. Gjithashtu, sipas z. Shala, Paneli e trajtoi refuzimin e trajtimit mjekësor si provë të synimit për të vrarë, pavarësisht se ky vendim u mor pa përfshirjen e z. Shala.<sup>277</sup>

<sup>273</sup> Shih Aktgjykimin, para. 936-943; Aktgjykimin e Apelit, para. 619-621.

<sup>274</sup> Kërkesa e Shalës, para. 70.

<sup>275</sup> Kërkesa e Shalës, para. 71.

<sup>276</sup> Kërkesa e Shalës, para. 71.

<sup>277</sup> Kërkesa e Shalës, para. 71.

Mbrojtja gjithashtu vëren se ngjarjet që çuan në vdekjen e viktimës ishin të pazakonta, se Paneli nuk shpjegoi qartë bazën për atribuimin e përgjegjësisë zotit Shala, dhe se ai nuk kishte synimin kriminal të nevojshëm.<sup>278</sup> Në përgjithësi, Mbrojtja parashtron se këto mangësi shkelën të drejtën e z. Shala për një vendim të arsyetuar mirë.<sup>279</sup>

162. ZPS-ja përgjigjet se Pika 8 është e papranueshme dhe duhet të rrëzohet menjëherë sepse z. Shala nuk evidenton asnjë gabim ligjor apo procedural në Aktgjykimin e Apelit, por vetëm përsërit mospajtimet mbi faktet, tashmë të paraqitura dhe të rrëzuara në apel.<sup>280</sup> ZPS-ja parashtron se në argumentet e tij thjesht përsëriten kundërshtimet ndaj fushëveprimit të planit të përbashkët të NKP-së dhe ndaj përgjegjësisë së tij për vrasjen e paligjshme, pa u futur në trajtimin e arsyetimit të Panelit të Apelit, dhe se z. Shala kryesisht mbështetet në pretendime faktike që dalin jashtë kuadrit të një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.<sup>281</sup> ZPS-ja gjithashtu argumenton se z. Shala keqinterpreton jurisprudencën tashmë të pranuar: Përgjegjësia sipas NKP-së nuk kërkon që ti të kesh luajtur “rol integral” në kryerjen e krimit, por të kesh dhënë kontribut të qenësishëm me synimin e nevojshëm; ajo gjithashtu nuk kërkon të kesh patur synimin për të vrarë një viktimë konkrete; dhe Trupi Gjykses bëri konstatime në lidhje me llojin e synimit që kishte z. Shala, të cilat u konfirmuan shprehimisht në apel.<sup>282</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës Supreme

163. Paneli fillimisht vëren se z. Shala nuk evidenton ndonjë shkelje thelbësore të një procedure konkrete të Ligjit ose Rregullores.<sup>283</sup> Paneli rikujton se pala që kërkon mbrojtje të ligjshmërisë duhet të evidentojë shkeljen thelbësore të pretenduar të procedurave të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore, ta faktojë atë, dhe të provojë se si

---

<sup>278</sup> Kërkesa e Shalës, para. 72.

<sup>279</sup> Kërkesa e Shalës, para. 73.

<sup>280</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 74-75.

<sup>281</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 75.

<sup>282</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 76; Aktgjykimi i Apelit, para. 854-855. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit, para. 858-862.

<sup>283</sup> Kërkesa e Shalës, para. 70-73.

ka ndikuar thelbësisht në aktgjykimin e kundërshtuar.<sup>284</sup> Paneli gjithashtu nuk mund të trajtojë vlerësime mbi aspekte të fakteve dhe provave. Paneli vë në dukje mosrespektimin prej z. Shala të këtyre standardeve të pranueshmërisë.

164. Për shembull, Paneli vëren se z. Shala nuk trajton konstatimet e Panelit të Apelit ose nuk u referohet atyre.<sup>285</sup> Në vend të kësaj, ai kundërshton mbajtjen penalisht përgjegjës të tij në bazë të NKP I-shit prej Trupit Gjykses, si formë e përgjegjësise penale për vdekjen e viktimës, pa përcaktuar megjithatë nëse ky kundërshtim përbën pretendim për gabim ligjor apo për shkelje thelbësore të procedurave në kuptim të nenit 48(7) të Ligjit.<sup>286</sup> Në vend të kësaj, në argumentet e Mbrojtjes theksohet se z. Shala nuk ishte kryes i drejtpërdrejtë i vrasjes dhe se ishin të tjerë ata që luajtën një rol më të madh në ngjarjet që çuan në vdekjen e viktimës.<sup>287</sup>

165. Në lidhje me këtë, Paneli thekson se Mbrojtja kundërshton konstatimet faktike të Trupit Gjykses dhe vlerësimin prej tij të rolit dhe synimit kriminal të z. Shala në kuadër të planit të përbashkët, në vend që të evidentojë një gabim ligjor konkret në përcaktimin e përgjegjësise penale të tij sipas NKP I-shit. Paneli gjithashtu vëren se në pjesën tjetër të argumenteve të z. Shala trajtohen vetëm provat. Z. Shala thjesht nuk pajtohet me konstatimet faktike, pa u marrë me trajtimin e tyre siç kërkohet në bazë të nenit 48(7) të Ligjit dhe standardit të shqyrtimit të përmendur më lart.

166. Bazuar në sa më lart, Paneli konstaton se Pika 8 është e papranueshme dhe e rrëzon menjëherë atë.

## I. GABIME NË PËRCAKTIMIN E DËNIMIT (PIKA 9)

### 1. Parashtrimet

167. Mbrojtja argumenton se Trupi Gjykses dhe Paneli i Apelit shkelën parimin e

---

<sup>284</sup> Shih nenin 48(7)(b) të Ligjit; Vendimin në lidhje me Veselin, para. 37.

<sup>285</sup> Kërkesa e Shalës, para. 70-73.

<sup>286</sup> Kërkesa e Shalës, para. 70-73.

<sup>287</sup> Kërkesa e Shalës, para. 71.

ligjshmërisë sipas nenit 7 të KEDNJ-së kur e trajtuan shkallëzimin e zbatueshëm të dënimit thjesht si një faktor midis të tjerësh.<sup>288</sup> Mbrojtja argumenton se kjo bie ndesh me Kodin Penal të RFSJ-së të vitit 1976 ("Kodi Penal i RFSJ-së"), ku parashikohej një shkallëzim i detyrueshëm dënimi me pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim dhe i cili ishte ligji në fuqi në atë kohë.<sup>289</sup> Mbrojtja gjithashtu pretendon se mbështetja e Trupit Gjykses dhe e Panelit të Apelit në nenin 44(2) të Ligjit ishte e gabuar sepse kjo dispozitë hyri në fuqi gjashtëmbëdhjetë vjet pas ngjarjeve dhe, për rrjedhojë, nuk mund të ndikonte nga pikëpamja ligjore në përcaktimin e dënimit.<sup>290</sup> Z. Shala gjithashtu argumenton se Trupi Gjykses bëri gabim ligjor që e dënoi atë për krime që pretendohet se janë kryer ndaj tetëmbëdhjetë individëve dhe jo ndaj nëntë individëve të renditur në Aktakuzë.<sup>291</sup> Së fundi, z. Shala argumenton se koha që ka kaluar duhej të ishte marrë parasysh si faktor lehtësues.<sup>292</sup> Si rezultat, Mbrojtja deklaron se dënimi i dhënë për z. Shala duhet të ulet.

168. ZPS-ja parashtron se në Pikën 9 shpërfilllet korniza ligjore autonome sipas së cilës funksionojnë Dhomat e Specializuara dhe pretendohet në mënyrë të pasaktë se dispozitat ligjore vendore mbi dënimet të Kodit Penal të RFSJ-së të vitit 1976, duhet të zbatohen drejtpërdrejt.<sup>293</sup> Z. Shala u shpall fajtor për krime lufte sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare, jo sipas Kodit Penal të RFSJ-së, dhe jurisprudenca detyruese konfirmon se përcaktimi i dënimit bëhet në bazë të Ligjit dhe të drejtës zakonore ndërkombëtare, kurse legjislacioni vendor është relevant vetëm në qoftë se është në pajtim me to.<sup>294</sup> ZPS-ja gjithashtu vëren se edhe sipas interpretimit të gabuar të z. Shala, dënimi i tij përfshihet në shkallëzimin e dënimit të parashikuar në Kodin Penal të RFSJ-së, dhe se në argumentet e tjera të tij në lidhje me vonesën dhe numrin e

---

<sup>288</sup> Kërkesa e Shalës, para. 74.

<sup>289</sup> Kërkesa e Shalës, para. 74.

<sup>290</sup> Kërkesa e Shalës, para. 74.

<sup>291</sup> Kërkesa e Shalës, para. 75.

<sup>292</sup> Kërkesa e Shalës, para. 76.

<sup>293</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 79-80.

<sup>294</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 79-81.

viktimave, ose përsëriten pretendime të hedhura poshtë më parë, ose ato janë të pasakta nga pikëpamja faktike, pasi Paneli i Apelit shfuqizoi disa verdikte fajësie dhe ia uli dënimin.<sup>295</sup> Sipas ZPS-së, z. Shala nuk evidenton asnjë gabim ligjor në lidhje me përcaktimin e dënimit apo me parimin, dhe, rrjedhimisht, Pika 9 duhet të rrëzohet ose të deklarohet e papranueshme.

169. Mbrojtja e Viktimave përgjigjet se Pika 9 është e papranueshme, pasi Mbrojtja, pa provuar asnjë gabim ligjor, përsërit argumente në lidhje me përcaktimin e dënimit që tashmë janë rrëzuar në apel.<sup>296</sup> Sipas Mbrojtjes së Viktimave, pretendimi i Mbrojtjes se shkallëzimet e dënimeve sipas Kodit Penal të RFSJ-së, ishin të detyrueshme, është trajtuar në mënyrë të njëmendtë dhe është rrëzuar prej Panelit të Apelit, që konfirmoi se ato shkallëzime nuk ishin detyruese për Dhomat e Specializara dhe se, gjithsesi, ato u morën parasysh si faktor relevant.<sup>297</sup>

170. Mbrojtja e Viktimave gjithashtu vëren se Mbrojtja keqinterpretonte bazën faktike të dënimit me pretendimin se z. Shala u dënua për tetëmbëdhjetë viktima, por shpërfill faktin se Paneli i Apelit shfuqizoi disa verdikte fajësie dhe ia uli dënimin.<sup>298</sup> Së fundi, sipas Mbrojtjes së Viktimave, Mbrojtja nuk faktonte pretendimin e vet se koha që ka kaluar përbën faktor lehtësues, një argument ky për të cilin Paneli i Apelit konstatoi se ishte i mjegullt dhe i pambështetur, veçanërisht duke pasur parasysh peshën e krimeve dhe dënimit e mëpasshëm penal të z. Shala në Belgjikë.<sup>299</sup>

171. Z. Shala përgjigjet se Prokuroria dhe Mbrojtja e Viktimave mbështeten gabimisht në faktin se dënimi me 13 vjet burgim përfshihet në shkallëzimin e dënimit të përcaktuar në Kodin Penal të RFSJ-së, dhe argumenton se shkallëzimet e dënimeve

---

<sup>295</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 82-83.

<sup>296</sup> Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 26-28.

<sup>297</sup> Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 26; Aktgjykimi i Apelit, para. 896, 899. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit, para. 833-885, 891-895.

<sup>298</sup> Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 27; Aktgjykimi i Apelit, para. 907. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit, para. 191-200.

<sup>299</sup> Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 28; Aktgjykimi i Apelit, para. 917.

pasqyrojnë hierarkinë e peshës së veprave penale dhe se në to përcaktohet pesha maksimale e një veprë penale.<sup>300</sup> Mbrojtja parashtron se, edhe pse dënimi nominalisht përfshihej në shkallëzimin prej pesë deri 15 vjetësh, Paneli i Apelit zbatoi në mënyrë të paligjshme një kuadër më të gjerë dënimi që lejonte dënimin me burgim të përjetshëm, me çka zgjeroi në mënyrë të palejueshme kufirin maksimal të zbatueshëm dhe shkeli parimin e ligjshmërisë dhe nenin 7 të KEDNJ-së.<sup>301</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës Supreme

172. Paneli fillimisht vëren se z. Shala i referohet përgjithësisht nenit 7 të KEDNJ-së dhe nenit 44(2) të Ligjit.<sup>302</sup> Megjithatë, z. Shala nuk saktëson nëse është kryer shkelje thelbësore e procedurave apo e të drejtës penale. Paneli përsëri rikujton se pala që kërkon mbrojtje të ligjshmërisë duhet të evidentojë shkeljen thelbësore të procedurave të përcaktuara në këtë Ligj dhe në Rregullore.<sup>303</sup>

173. Paneli kupton se argumentet që sjell z. Shala lidhen me pretendimin se Trupi Gjykses dhe Paneli i Apelit, në kuadër të përcaktimit të dënimit të tij, shkelën të drejtën penale duke mos zbatuar atë çka ai pretendon se ishte ligj në fuqi në kohën e kryerjes së veprave penale.<sup>304</sup> Sipas z. Shala, shkallëzimi i dënimit i parashikuar për rastin e tij është pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.<sup>305</sup> Z. Shala pretendon se neni 44(2) i Ligjit hyri në fuqi 16 vjet pas Kodit Penal të RFSJ-së dhe nuk mund “të ndikonte ligjërisht në përcaktimin e kuadrit të zbatueshëm për përcaktimin e dënimeve”.<sup>306</sup>

174. Paneli rikujton se DHSGJK-ja ka konfirmuar se Dhomat e Specializuara funksionojnë në mënyrë autonome, në përputhje me kornizën e përcaktuar ligjore të

---

<sup>300</sup> Kundërpërgjigjja e Shalës, para. 14.

<sup>301</sup> Kundërpërgjigjja e Shalës, para. 15.

<sup>302</sup> Kërkesa e Shalës, para. 74-77.

<sup>303</sup> Shih nenin 48(7)(b) të Ligjit; Vendimin në lidhje me Veselin, para. 37.

<sup>304</sup> Kërkesa e Shalës, para. 74.

<sup>305</sup> Kërkesa e Shalës, para. 74.

<sup>306</sup> Kërkesa e Shalës, para. 74.

tyre.<sup>307</sup> DHSGJK-ja gjithashtu ka vënë në dukje se “nga një lexim i thjeshtë i nenit 44(2) të Ligjit del qartë se as shkallëzimi i dënimeve në kohën e kryerjes së veprës penale, as ndonjë shkallëzim tjetër më i butë i mëvonshëm i përcaktuar në legjislacionin e Kosovës për atë vepër penale, nuk është detyrues për dhomat penale”.<sup>308</sup> DHSGJK-ja saktësoi se “interpretimi tekstual i formulimit të dispozitës tregon pa mëdyshje se, ndonëse dhomat penale janë të detyruara t’i marrin parasysh këto shkallëzime kur përcaktojnë dënimin që do t’i jepet një personi të shpallur fajtor për një vepër penale sipas të drejtës ndërkombëtare, ato nuk janë të detyruara t’i zbatojnë ato”.<sup>309</sup>

175. Paneli vëren se z. Shala nuk përpiqet të sjellë argumente se Kodi Penal i RFSJ-së është ai që parashikon shkallëzimin më të butë të dënimit, as jep argumente që sugjerojnë se Trupi Gjykses apo Paneli i Apelit gabuan në zbatimin prej tyre të nenit 44(2) të Ligjit. Në këtë aspekt, Paneli u referohet udhëzimeve të përcaktuara në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, të cilat Paneli i Apelit i ndoqi me kujdes gjatë vlerësimit të dënimit me burgim të z. Shala sipas nenit 44(2) të Ligjit.<sup>310</sup> Sidoqoftë, dënimi me burgim i dhënë në rastin e z. Shala është brenda shkallëzimit të dënimit që ai pretendon se duhej të ishte zbatuar ndaj tij, dhe z. Shala nuk jep ndonjë argument që të bën të kuptosh se Trupi Gjykses apo Paneli i Apelit keqpërdorën diskrecionin e tyre në këtë aspekt.

176. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Pika 9 duhet të rrëzohet.

## V. KLASIFIKIMI

177. Së fundi, Paneli vë në dukje se Përgjigjja e ZPS-së, Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave dhe Kundërpërgjigjja e Shalës janë të klasifikuara si konfidenciale.

---

<sup>307</sup> KSC-CC-2024-27, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Salih Mustafës në lidhje me Të Drejtat Themelore të Garantuara nga Nenet 31 dhe 33 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 17 prill 2025 (“Vendimi i DHSGJK-së”), para. 113.

<sup>308</sup> Vendimi i DHSGJK-së, para. 115

<sup>309</sup> Vendimi i DHSGJK-së, para. 115.

<sup>310</sup> Vendimi në lidhje me Mustafën, para. 75-111.

Rrjedhimisht, Paneli urdhëron z. Shala, ZPS-në dhe Mbrojtjen e Viktimave të dorëzojnë versionet publike ose të redaktuara publike të parashtrimeve të tyre brenda 14 ditësh nga marrja e njoftimit për këtë Vendim.

## VI. VENDIM

178. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës Supreme

- a. **RRËZON** Kërkesën në tërësi; dhe
- b. **URDHËRON** z. Shala, ZPS-në dhe Mbrojtjen e Viktimave të dorëzojnë versionet publike ose të redaktuara publike të parashtrimeve të tyre brenda 14 ditësh nga marrja e njoftimit për këtë Vendim.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova, Kryegjykatëse**

E hënë, 9 mars 2026

Në Hagë, Holandë